



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.117

10 gusht

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Urdhër i MB nr.409, datë 3.7.2009	Për pajisjen me dokumente identiteti të shtetasve shqiptarë...	5609
Vendim i GJK nr.18, datë 8.7.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.371, datë 7.7.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr.00-2008-113, datë 18.1.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si të papajtueshme me Kushtetutën	5609
Vendim i GJK nr.19, datë 9.7.2009	Me objekt shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësie të qeverisjes vendore”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë	5613
Vendim i GJK nr.20, datë 9.7.2009	Me objekt shfuqizimin e neneve 37/2; 38/a, b të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si të papajtueshme me Kushtetutën”.....	5617
Vendim i GJK nr.26, datë 24.7.2009	Me objekt shfuqizimin e fjalisë “Paga bazë e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë” dhe të fjalisë “Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind”, të nenit 26/2 të ligjit nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si të papajtueshme me Kushtetutën.....	5625
Vendim i GJL nr.1, datë 8.1.2009	Me objekt revokimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe lirimin e menjëhershëm të kërkuesit.....	5629
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Valbona Azem Harizaj	5640

URDHËR
Nr.409, datë 3.7.2009

PËR PAJISJEN ME DOKUMENTE IDENTITETI TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupit të Sagem Securite dhe fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit të aplikimit për dokumentet e identitetit, pasaportë elektronike dhe letërnjoftim për të gjithë shtetasit shqiptarë mbi 16 vjeç.
2. Orari i punës, për zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, do të jetë orari zyrtar.
3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohen prefektët, njësitë e qeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
4. Urdhri nr.350, datë 28.5.2009 “Për aplikimin e shtetasve shqiptarë, të cilët disponojnë pasaportë për jashtë shtetit për pajisje me letërnjoftim elektronik” dhe çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.18, datë 8.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 19.2.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.37/22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Asllan Zdrava, Fatos Zdrava, Agron Zdrava, Shpresa Agaj, të përfaqësuar nga avokat Rustem Gjata, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1.Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në mungesë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, në mungesë.

3. Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, përfaqësuar nga avokati i shtetit Abaz Deda, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.371, datë 7.7.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe i vendimit nr.00-2008-113, datë 18.1.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 18/1, 42 e 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Petrit Piloçi; përfaqësuesin e kërkuësve, që kërkoji pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, që kërkoji rrëzimin e kërkesës dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Me vendimin datë 20.4.1999, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Durrës, trashëgimtarët e ish-pronarëve Ramazan Zdrava (Fatos Zdrava, Asllan Zdrava, Agron Zdrava dhe Shpresa Agaj) dhe Rifat Deliallisi (Naze Deliallisi, Hilmi Deliallisi, Ëngjellushe Fani dhe Abdulla Deliallisi), janë njohur pronarë dhe u është kthyer një sipërfaqe toke prej 6151m², e ndodhur në Shkozë, Durrës. Kjo pronë është regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me numër pasurie 5/313, në emër të të gjithë trashëgimtarëve.

Për ndërtimin dhe rehabilitimin e segmentit rrugor LINK-ROAD, që lidh Interchange Shkozë dhe rrugën kombëtare Tiranë-Durrës, bazuar në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, është bërë shpronësimi i disa pasurive të paluajtshme, mes të cilave dhe një sipërfaqe prej 1048 m², pjesë e pronës së lartpërmendur.

Ky shpronësim është miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.416, datë 19.6.2003 dhe sipas listës së pronarëve që shpronësohen, bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave, rezultojnë se secili nga bashkëpronarët është shpronësuar në sipërfaqen 131 m², që i përket nr.pasurie 5/313, duke u llogaritur vlera e shpërblimit me çmimin 2000 lekë/m².

Duke mos qenë dakord me vlerën e shpërblimit për shpronësimin, shtetasi Abdulla Deliallisi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila në përfundim të gjyqimit, me vendimin nr.1769, datë 16.10.2003, ka vendosur pranimin e padisë dhe ndryshimin e masës së shpërblimit për të gjithë bashkëpronarët.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.129, datë 17.3.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm të gjykatës së faktit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me arsyetimin se vendimi është rrjedhojë e mosrespektimit të kërkesave procedurale për formimin drejt të ndërgjyqësisë dhe se gjykata duhej të kishte thirrur në gjykim edhe bashkëpronarët e tjerë, përderisa ata kanë interes në këtë çështje.

Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.2244, datë 19.11.2004, ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të paditësit dhe personave të tretë vlerën për shpronësimin, sipas dispozitivit të vendimit.

Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.371, datë 7.7.2006, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit, pranimin e kërkesëpadisë së paditësit Abdulla Deliallisi dhe personave të tretë, Ëngjellushe Deliallisi dhe Hilmi Deliallisi, dhe rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga personat e tretë, Agron Zdrava, Asllan Zdrava, Fatos Zdrava dhe Shpresa Agaj, duke arsyetuar se këta të fundit (kërkuësit), kanë qenë dakord me vendimin e Këshillit të Ministrave 416 - për këtë arsye kanë tërhequr vlerën e shpronësimit - dhe se kërkimet e tyre janë ngritur jashtë afatit ligjor 30-ditor.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr.00-2008-113, datë 18.1.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Fatos Zdrava, Asllan Zdrava, Agron Zdrava dhe Shpresa Agaj.

Kërkuësit pretendojnë se u është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

- Gjykata e apelit e ka marrë vendimin në kundërshtim me faktet e provuara dhe ligjin material e procedural dhe nuk e ka mbështetur konkluzionin e saj në asnjë dispozitë ligjore. Fakti që kërkuesit kanë tërhequr shumën e vlerësimit të caktuar nga shteti, nuk ngarkohet nga ligji me asnjë pasojë juridike.

- Argumentimi i gjykatës së apelit se kërkimet janë ngritur jashtë afatit ligjor nuk qëndron, pasi akti administrativ ka qenë i përbashkët dhe ai është goditur nga paditësi për llogari të të gjithë bashkëpronarëve.

- Gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim diskriminues. Bazuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe në nenin 14 të KEDNJ-së, duke qenë një pasuri e përbashkët, kërkuesit janë në kushte të barabarta me bashkëpronarët e tjerë dhe gjykata nuk kishte asnjë shkak juridik për t'i trajtuar ndryshe.

- Jo kushtetues është dhe vendimi i Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur, megjithëse ai përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ishte i detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, kërkoi përpara Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar:

- Nga lista e pronarëve që shpronësohen për shkak të ndërtimit të rrugës rezultojnë se personat e shpronësuar janë përcaktuar nominalisht në të dhe, në këto kushte, secili prej tyre duhej të ankimonte vendimin e shpronësimit brenda afatit ligjor.

- Kërkuesit kanë qenë dakord me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.416, datë 19.6.2003 dhe për këtë arsye kanë bërë tërheqjen e vlerës së shpronësimit.

- Kërkuesit janë thirrur nga gjykata kryesisht në rigjykimin e çështjes, pra ata nuk i janë drejtuar asaj me padi për kundërshtimin e aktit (VKM) brenda afatit ligjor 30-ditor.

II

Në kërkesën e paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi i referohet rregullimit kushtetues të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ, që lidhet me respektimin e standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, veçanërisht në vështrim të respektimit të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës.

1. Lidhur me cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit në gjykatë)

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 42 të saj, ka garantuar të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive e interesave të tyre kushtetuese dhe ligjore, ku një aspekt i rëndësishëm i së cilës është edhe e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit). E drejta e aksesit nënkupton jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.15, datë 17.4.2003; nr.9, datë 2.4.2003; nr.17, datë 18.7.2008; nr.5, datë 6.3.2009*). Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa i njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.

Gjykata Kushtetuese thekson se, në përputhje me parimet e sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës, Kodi i Procedurës Civile rregullon/implementon të drejtën e aksesit në një sërë dispozitash të tij. Kështu, Kodi rregullon të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë, e cila, duke pasur parasysh natyrën e saj si arbitër, nuk procedon me nismën e vet, nëse nuk vihet në lëvizje nga palët (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Në çdo rast është pala inicuese ajo që tregon objektin e gjykimit dhe kështu, gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (neni 6 i K.Pr.Civile). Përveç këtyre, Kodi i Procedurës Civile parashikon një tërësi rregullimesh të tjera parimore dhe specifike, si parakushte për realizimin e të drejtës individuale të aksesit në një gjykatë.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje gjithashtu se, përveç sa sipër, nenet 161 e 162 të K.Pr.Civile parashikojnë edhe institutin e bashkëndërgjyqësisë. Konkretisht, neni 161 parashikon bashkëndërgjyqësinë në parim, duke u shprehur se: "*Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ... (bashkëndërgjyqës) në rast se: a) kanë të drejta ose detyrime të përbashkëta mbi objektin e padisë; ndërsa neni 162 parashikon njërin nga llojet e bashkëndërgjyqësisë, atë të detyrueshme, duke u shprehur se: "... Kur, për shkak të natyrës së marrëdhënieve juridike që janë në konflikt ose për shkak të një dispozite ligjore, efekti i vendimit, që do të jepet, shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet*

procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt edhe për bashkëndërgjyqësit e tjerë që nuk janë paraqitur në gjykatë ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vëren se, në vështrim të nenit 162 të Kodit të Procedurës Civile, në rastin e shpronësimit për interes publik të një pasurie të paluajtshme, e cila figuron në bashkëpronësi të disa subjekteve, padia për kërkimin e një shpërblimi të drejtë, është një rast i bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme. Kjo do të thotë se kjo padi ngrihet nga të gjithë subjektet/bashkëpronarët, të cilëve iu drejtohet akti. Megjithatë, edhe në rast se padia ngrihet nga njëri ose disa prej bashkëpronarëve, në kuptim të dispozitave të mësipërme të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka efekt edhe për bashkëpronarët e tjerë, që nuk janë paraqitur në gjykatë, ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar.

Në rastin në shqyrtim, nga dokumentet e dosjes gjyqësore, Gjykata Kushtetuese konstaton se në momentin e shpronësimit, sipërfaqja prej 1048 m² ishte në bashkëpronësi të të gjithë bashkëpronarëve Deliallisi dhe Zdrava. Gjykatat, në vendimet e tyre, duke iu referuar kësaj prone, shprehen se: *“është shpronësuar një sipërfaqe truall prej 1048 m² e familjes Deliallisi-Zdrava, duke i takuar secilit bashkëpronar nga 131 m² truall i shpronësuar”, apo se: “paditësi, me cilësinë e njërit prej bashkëpronarëve ka kundërshtuar masën e shpërblimit”.* Po kështu, duke iu referuar listës së pronarëve të shpronësuar, që i është bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr.416, sipërfaqet prej 131 m² të shpronësuar secilit prej anëtarëve të familjeve Deliallisi dhe Zdrava, megjithëse janë të listuara më vete për secilin bashkëpronar, i përkasin së njëjtës pasuri, asaj me nr.5/313.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese, duke pasur parasysh se në momentin e shpronësimit prona ka qenë në bashkëpronësi të të gjithë bashkëpronarëve Deliallisi dhe Zdrava, konkludon se padia për kërkimin e shpërblimit të drejtë për shkak të shpronësimit për interes publik të truallit në bashkëpronësi, përbën një rast të bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme. Për pasojë, padia e ngritur nga Abdulla Deliallisi ka efekt edhe për bashkëpronarët e tjerë. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.129, datë 17.3.2004, ka prishur me të drejtë vendimin e gjykatës së faktit dhe ka kërkuar që edhe këta bashkëpronarë të jenë palë në këtë gjykim, duke respektuar kështu edhe të drejtën e aksesit në gjykatë të këtyre të fundit. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Durrës duhej të kishte zbatuar dispozitat e neneve 161 dhe 162 të Kodit të Procedurës Civile, duke i konsideruar veprimet e kryera nga Abdulla Deliallisi si të kryera edhe prej bashkëpronarëve të tjerë, të cilët nuk kishin paraqitur ankim në afatin e caktuar dhe nuk kishin marrë pjesë në gjykimin në shkallë të parë.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se, në rastin në shqyrtim, Gjykata e Apelit Durrës që i ka nxjerrë bashkëpronarët Zdrava jashtë afatit dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës pa e zgjidhur çështjen në themel, u ka cenuar atyre të drejtën e aksesit në gjykatë, si aspekt i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

2. Lidhur me pretendimin për shfuqizimin si jokushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë

Kërkuesit kanë kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur mospranimi i rekursit të paraqitur nga Fatos Zdrava, etj. Ata pretenduan se rekursi përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile dhe, për pasojë, Kolegji Civil ishte i detyruar ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Gjykata Kushtetuese, mbështetur edhe në një jurisprudencë të konsoliduar në këtë drejtim, thekson se, bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Seleksionues në dhomën e këshillimit është organi që bën vlerësimin nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Megjithatë, nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit civil, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 19.07.2005).

Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur Gjykata Kushtetuese konstaton shkeljen e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës (të drejtës së aksesit) nga ana e gjykatës së apelit dhe kur kjo shkelje nuk është konstatuar nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, atëherë, edhe ky Kolegj ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues. Për pasojë, edhe ky vendim i Kolegjit Civil, i marrë në dhomën e këshillimit, duhet të shfuqizohet si jokushtetues.

Për sa sipër, kërkesa e paraqitur nga kërkuesit Asllan Zdrava, Fatos Zdrava, Agron Zdrava dhe Shpresa Agaj, duhet të pranohet si e bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/1/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë vendimin nr.371, datë 7.7.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr.00-2008-113, datë 18.1.2008 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Petrit Ploçi, Sokol Berberi, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Kujtim Puto, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori.

VENDIM

Nr.19, datë 9.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza,	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 19.3.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.1 Akti, që i përket:

KËRKUES: Këshilli i bashkisë Himarë, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore”.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 18, 111, 131 shkronja “c” dhe 134/1 shkronja “e” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 49 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi; përfaqësuesen e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës; shqyrtoi pretendimet me shkrim të parashtruara nga kërkuesi dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në mbështetje të dispozitave të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësisive të qeverisjes vendore.”

Pika 2 e këtij vendimi parashikon se: “Kur shoqëria e ujësjellësve dhe kanalizimeve mbulon më shumë se një njësi qeverisjeje vendore, bazuar në shitjen me pakicë, në marrëdhëniet tregtare me përdoruesit finalë, aksionet e shoqërisë, që transferohen, u kalojnë njësisive të qeverisjes vendore përkatëse në bashkëpronësi, ku pjesa takuese e aksioneve të çdo njësie është në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë së asaj njësie, që mbulohet nga shoqëria e ujësjellësve dhe kanalizimeve.

2. Kërkuesi, në kërkesën e paraqitur me shkrim, ka pretenduar se:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave vjen në kundërshtim me nenin 11 të Kushtetutës - që garanton lirinë e veprimtarisë ekonomike - pasi e ka detyruar bashkinë e Himarës të bëhet aksionare në një shoqëri anonime kundër vullnetit të saj;

- Pika 2 e këtij akti nënligjor është në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës – që parashikon barazinë para ligjit – pasi kriteri “banorë për njësi vendore”, i përdorur për të përcaktuar numrin e aksioneve që i takojnë një njësie të qeverisjes vendore nuk është kriter ekonomik.

3. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka parashtruar se kërkesa duhet rrëzuar për arsye se:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 nuk ka tejkaluar ndonjë nga kufizimet që mund të ketë vendosur ligji nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”.

- Rregullimet e realizuara nga Këshilli i Ministrave përmes këtij vendimi janë kryer në kuadër të rezervës ligjore absolute, me qëllim zbatimin e urdhërimeve të ligjit të sipërcituar. Në kuptim të rregullimit që parashikon neni 50 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, kufizimet që mund të jenë vendosur nga ligji nuk vlerësohen nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, për shkak të kalimit të më shumë se 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e ligjit.

II

1. Lidhur me zhvillimin e gjykimit kushtetues në mungesë të kërkuarit

Gjykimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) është zhvilluar në seancë publike në prani vetëm të përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Këshilli i Ministrave, dhe pas shqyrtimit të pretendimeve me shkrim të paraqitura nga Këshilli i Bashkisë Himarë për arsye se avokati i caktuar për përfaqësimin e kërkuarit në këtë gjykim kushtetues nuk është paraqitur. Avokati i kërkuarit ka kërkuar, nëpërmjet një njoftimi me shkrim të paraqitur në datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën Kushtetuese, shtyrjen e gjykimit, për shkak të përfaqësimit të një shtetasi në një gjykim tjetër civil që zhvillohej në të njëjtën ditë në Gjykatën e Lartë.

Nisur nga specifika që paraqet procedura e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe për arsye të zhvillimit korrekt të këtij gjykimi, me shkresën nr.1 akti, datë 19.1.2009 Gjykata i është drejtuar kërkuarit dhe subjektit të interesuar dhe i ka informuar për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, duke u kërkuar që brenda datës 9.2.2009 të paraqitnin komentet e tyre me shkrim, të cilat do të ishin në dispozicion të secilës palë për t’u studiuar. Kërkuesi nuk e ka çmuar të nevojshme përmbushjen e kësaj kërkesë procedurale dhe në ditën e caktuar për zhvillimin e seancës plenare (më datë 19.3.2009) ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shtyrjen e gjykimit me arsyen e sipërpërmendur.

Në bazë të nenit 38 pika 6 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata vlerëson se arsyeja për mospraninë e avokatit të kërkuarit në këtë gjykim, për shkak të angazhimit të tij për përfaqësimin e një shtetasi në një tjetër gjykim që zhvillohej në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që ka pasur kohën e mjaftueshme për t’iu përgjigjur kërkesave procedurale të gjykimit kushtetues, nuk përbën shkak të përligjësimit për shtyrjen e gjykimit. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi të zhvillojë gjykimin në mungesë të kërkuarit, duke u bazuar në pretendimet me shkrim të paraqitura prej tij më datën 13.11.2008.

2. Lidhur me pretendimin se akti nënligjor, objekt i kërkesës, cenon parimin kushtetues të lirisë së veprimtarisë ekonomike

Në gjykimin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës juridike, inicimi i të cilit bëhet nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës, kërkohet të vlerësohet paraprakisht nga Gjykata prania e interesit ligjor të kërkuarit në çështjen në shqyrtim, për efekt të legjitimitetit të tij në gjykimin kushtetues. Për legjitimitetin e subjekteve, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë synon identifikimin e të drejtës së shkelur të subjektit si rrjedhojë e antikushtetutshmërisë në përmbajtje të normës juridike. Subjektet kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme, të drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ata kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak (*shih vendimin nr.12, datë 28.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kërkuari ka pretenduar se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007, duke parashikuar “*transferimin e aksioneve të shoqërive shtetërore të ujësjellësve dhe kanalizimeve në pronësi të njërive të qeverisjes vendore*”, e ka detyruar të bëhet aksionar në një shoqëri anonime jashtë vullnetit të tij, ndërkohë që liria e veprimtarisë ekonomike e parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës i krijon mundësinë personave fizikë dhe juridikë, që sipas vlerësimit të tyre, të hyjnë ose jo në marrëveshje të ndryshme ekonomike ose tregtare.

Gjykata e ka interpretuar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike të garantuar nga neni 11 i Kushtetutës. Sipas saj, kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individ, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 19.3.2008*). Liria e veprimtarisë ekonomike përmban gjithashtu edhe detyrimin e shtetit që, nëpërmjet ligjvënësit, të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që, krahas lirisë së veprimtarisë ekonomike, të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i të mirës së përbashkët (*shih vendimin nr.10, datë 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Liria e veprimtarisë ekonomike, duke u konsideruar si një nga parimet bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë, ka gjetur pasqyrimin në pjesën e parë të Kushtetutës, ku parashikohen “Parimet themelore” mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit. Liria e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike parashikohet gjithashtu edhe në pjesën e gjashtë: “Qeverisja vendore” dhe konkretisht në nenin 113 shkronja “b”, sipas të cilit “*këshillat komunalë, bashkiakë dhe të qarkut ushtrojnë të drejtat e pronës, administrojnë në mënyrë të pavarur të ardhurat e krijuara, si dhe kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtari ekonomike*”.

Në këtë kuptim, ndërhyrjet e pushtetit qendror në ushtrimin e këtyre të drejtave nga organet e qeverisjes vendore, në këndvështrim të mbrojtjes së parimit të autonomisë vendore dhe decentralizmit të pushtetit, konsiderohen si çështje të juridiksionit kushtetues dhe si të tilla vlerësohen nga Gjykata. Për rrjedhojë, organet e qeverisjes vendore mund të iniciojnë në Gjykatën Kushtetuese një procedurë të kontrollit abstrakt të pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare kur argumentojnë se çështja lidhet me cenimin e parimit të decentralizmit të pushtetit ose të autonomisë vendore – të cilat përfshihen si “*interesat e tyre*” (neni 134/1/e dhe 134/2 të Kushtetutës).

Për rastin në shqyrtim, Gjykata konkludon se këshilli i bashkisë Himarë legjitimohet ta investojë atë në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 131 shkronja “c” të Kushtetutës lidhur me pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

Në respekt të këtyre standardeve, Gjykata vlerëson cenimin ose jo nga Këshilli i Ministrave të parimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike të organit vendor, në funksion edhe të parimit të autonomisë vendore dhe të rezervës ligjore, të parashikuara nga nenet 11, 113, shkronja “b” dhe 118 të Kushtetutës. Rregullimet e parashikuara nga këto dispozita të Kushtetutës duhen kuptuar në harmoni me njëri-tjetrin. Neni 11 pika 3 i ka rezervuar ligjit rregullimin e mëtejshëm mbi çështjet respektive (rezerva ligjore). Në rastin e *rezervës ligjore absolute* Gjykata thekson se është norma kushtetuese ajo që ia rezervon vetëm ligjit rregullimin e një marrëdhënieje konkrete, ndërsa në rastin e *rezervës ligjore relative*, çështja konkrete mund të rregullohet edhe nga aktet nënligjore. Shprehja “*vetëm me ligj*”, e parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës ka kuptimin se në rast se është i nevojshëm kufizimi i lirisë së veprimtarisë ekonomike, ky vlerësim është në diskrecionin vetëm të ligjvënësit (*shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Rezulton se vendimi i Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësie të qeverisjes vendore” ka dalë në mbështetje të ligjeve përkatëse. Konkretisht, në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” parashikohet, ndër të tjera, se komunat dhe bashkitë, në fushën e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike, ushtrojnë si funksione të veta edhe furnizimin me ujë të pijshëm. Për këto funksione, pushteti qendror mund të vendosë standarde e norma specifike me qëllim ruajtjen e interesave kombëtarë. Këto standarde e norma nuk mund të cenojnë ose kufizojnë autonominë e komunave dhe bashkive në çështje me interes vendor. Ligji nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” rregullon procesin e transferimit të pronave të paluajtshme publike, si dhe titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin e shoqërive tregtare ose ndërmarrjeve shtetërore në njësitë e qeverisjes vendore. Në këtë ligj përcaktohen pronat që do t’u transferohen njësie të qeverisjes vendore, natyra e të drejtave të njësie të qeverisjes vendore mbi to dhe procesi, sipas të cilit do të bëhet transferimi i pronave (neni 1). Në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë, pushteti qendror mund të vendosë kushte dhe kufizime mbi këtë të drejtë, të cilat duhet të jenë vetëm për të siguruar maksimumin e përfitimeve publike ose mbrojtjen e një karakteristike të veçantë të pronës (neni 7) dhe organi përgjegjës për zbatimin e ligjit është Këshilli i Ministrave, i cili ngarkohet të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e tij (neni 21).

Nga kjo pikëpamje, Gjykata vlerëson se, në lidhje me pretendimin e kërkuarit për ndërhyrjen e padrejtë në ushtrimin e lirë të veprimtarisë ekonomike, ajo nuk është bërë me vendimin e Këshillit të Ministrave, objekt shqyrtimi, por është pasojë e zbatimit të ligjeve të sipërcituara.

3. Lidhur me pretendimin se është cenuar barazia përpara ligjit

Kërkuari pretendon se vendimi i Këshillit të Ministrave, objekt shqyrtimi, bie ndesh me rregullimet e parashikuara nga neni 18 i Kushtetutës, për arsye se kriteri “*banorë për njësi vendore*”, i përdorur për të përcaktuar numrin e aksioneve që i takojnë një njësie të qeverisjes vendore nuk është kriter ekonomik. Sipas kërkuarit, në kuptim të nenit 16 të Kushtetutës, referimi në konceptin e barazisë para ligjit është një standard i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që zbatohet edhe ndaj personave juridikë publikë.

Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se personat juridikë mund të jenë subjekte të të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar, “*për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve*”(neni 16 pika 2 e Kushtetutës). Disa nga këto liri dhe të drejta nuk është e mundur t’i atribuohen një personi juridik për shkak të thelbit të tyre ose qëllimit për të cilin ligji i ka dhënë jetë personit juridik. Përsa u përket të drejtave të tjera, personi juridik mund të jetë subjekt i tyre në atë masë dhe në atë kuptim që ato lehtësojnë gëzimin e plotë të këtyre të drejtave dhe lirive për individët.

Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, të cilit i referohet kërkuari, synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Nga ana tjetër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e së drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive.

Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimin nr.18, datë 29.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Nisur nga argumentet e parashtruara në kërkesë, Gjykata thekson se vetëm referimi që bën kërkuari të neni 18 i Kushtetutës, pa analizuar ekzistencën e pabarazisë për arsye të papërligjura ndërmjet subjekteve të tjerë të qeverisjes vendore, është një pretendim i pamjaftueshëm për të provuar dhe për të konkluduar mbi antikushtetutshmërinë e vendimit të Këshillit të Ministrave. Detyrimi i kërkuarit është që të argumentojë në nivel kushtetues se Këshilli i Ministrave, me vendimin që ka nxjerrë, ka shkaktuar një pabarazi ligjore ndërmjet këtyre subjekteve, në mungesë të një përligjje të arsyeshme dhe objektive.

Nga kjo analizë kushtetuese, Gjykata konkludon se pretendimet e kërkuarit që lidhen me cenimin e parimit kushtetues të lirisë së veprimtarisë ekonomike dhe të parimit të barazisë përpara ligjit, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “c” dhe 134 pika 1 shkronja “e”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 38 dhe 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.660, datë 12.9.2007 “Për transferimin e aksioneve të shoqërive të ujësjellësve dhe kanalizimeve njësive të qeverisjes vendore”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi

VENDIM

Nr.20, datë 9.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 11.12.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.31/16 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj, me autorizim.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i neneve 37/2; 38/a, b të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkonte pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, që kërkon rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) në datën 18.2.2008 miratoi ligjin nr.9877 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj përcakton krijimin, organizimin dhe kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, masat disiplinore dhe shkarkimin e tyre, si

dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e gjykatave (neni 1). Ndër të tjera ky ligj parashikon, në një kre të veçantë, dispozita për “Administrimin e shërbimeve në gjykatë”. Në nenin 37 të titulluar “Kancelari i gjykatës” parashikohet: “1. Kancelari i gjykatës drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në gjykatë. 2. Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë”. Në nenin 38 të ligjit parashikohen “Kompetencat e kancelarit”. Kjo dispozitë, në shkronjat “a” dhe “b”, parashikon: “Kancelari i gjykatës ka këto kompetenca kryesore: a) emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës; b) mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore të gjyqtari i caktuar; ...”.

Kërkuesi, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve (SHKGJ), i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 37 pika 2 dhe 38, shkronjat “a” dhe “b” të cituara më sipër, të ligjit nr.9877 me pretendimin se, këto dispozita cenojnë parimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 4, pika 2; 7 dhe 145, pika 1 dhe 3, të Kushtetutës, bazuar në këto argumente:

- Nenet 4/2 dhe 7 të Kushtetutës kanë si qëllim t’i japin pushtetit gjyqësor një vend autonom, të ndarë, por dhe të balancuar nga dy pushtetet e tjera, atij ligjvënës dhe ekzekutiv. Përcaktimet urdhëruese kushtetuese në nenin 145/1, 3 synojnë të garantojnë jo vetëm një pushtet gjyqësor të pavarur, por edhe që organizimi dhe funksionimi i këtij pushteti të jetë tërësisht i tillë. Ligji ekspozon pushtetin gjyqësor ndaj presioneve politike apo nga pushteti ekzekutiv.

- Një nga mjetet më të rëndësishme për mbrojtjen e pavarësisë së organeve apo institucioneve të pushtetit gjyqësor është veçanërisht përcaktimi i saktë i mekanizmave dhe procedurave për zgjedhjen, emërimin dhe sidomos shkarkimin jo vetëm të gjyqtarëve, por edhe të drejtuesve të tjerë administrativë (kancelarit), apo të personelit administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës. Vetëm në këtë mënyrë do të garantohen tre nga komponentët më të rëndësishëm të pavarësisë, që janë: pavarësia organizative, pavarësia funksionale dhe pavarësia financiare. Të tre këta komponentë të pavarësisë reale të gjyqësorit cenohen nga dy nenet e ligjit të kundërshtuar, objekt i kërkesës.

- Menaxhimi i administrimit të shërbimeve të pushtetit gjyqësor nga pushteti ekzekutiv me anë të Ministrit të Drejtësisë (MD), sipas ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, e bën të vështirë koordinimin e shërbimeve të nevojshme për publikun nga pushteti gjyqësor, pasi nga ky proces janë përjashtuar kryetarët e gjykatave apo Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD).

- Për të gjitha organet kushtetuese të pavarura, ligjet organike të tyre kanë siguruar një autonomi organizative, funksionale dhe financiare, si kritere të domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre kushtetuese dhe ligjore. Nenet e kundërshtuara të ligjit, objekt shqyrtimi, në dallim nga këto rregullime ligjore për organet kushtetuese të pavarura, cenojnë autonominë e pushtetit gjyqësor.

- Nenet e kundërshtuara të ligjit, objekt shqyrtimi, bien ndesh me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, me Paktet e OKB-së, me Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit, miratuar nga Asambleja e OKB-së, me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), me Kartën Universale të Gjyqtarit, etj.

Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave (KM), parashtruan se kërkesa është e pabazuar dhe duhet rrëzuar, për këto arsye:

- Nga neni 7 i Kushtetutës del qartë se epiteti kushtetues që i atashohet “pushtetit gjyqësor” nuk është “pavarësia”, por “ndarja dhe balancimi me atë legjislativ dhe ekzekutiv”. Në këtë mënyrë, nuk mund të shihet “pushteti gjyqësor i pavarur” pa asnjë lidhje nga institucionet e tjera që, sipas rastit, ushtrojnë funksione të tjera ligjvënëse ose ekzekutuese.

- Termi “pavarësi” i referohet gjyqtarit ose trupit gjykues, në një çështje konkrete, kur gjyqtari jep vendimin, pra ushtron funksionin e dhënies së drejtësisë. Linja logjike që përshkon në tërësi ligjin nr.9877, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” është realizimi i një ndarjeje të pastër, reale dhe pa asnjë konfondim midis dy veprimtarive në ambientet e gjykatës: funksioni i gjyqësisë (i dhënies së drejtësisë) dhe veprimtaria mbështetëse në shërbim të gjyqtarëve dhe në shërbim të publikut.

- Nga analiza krahasimore e ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin objekt i këtij gjykimi kushtetues, rezulton vetëm një situatë juridike e ndryshuar “emërimi dhe shkarkimi i sekretarisë gjyqësore”. Kështu, procedura e emërim/shkarkimit të kancelarit dhe të një pjese të administratës gjyqësore ka përfutur natyrën e sigurt juridike për shkak të zbatimit të pandërprerë dhe të zgjatur në kohë dhe pretendimet për shfuqizimin e tyre nuk mund të mbrohen në një gjykim kushtetues.

- Sekretaria gjyqësore ka në funksion dokumentimin e procesit gjyqësor, të cilin e kryen në mënyrë të pavarur dhe të painfluencuar nga palët, nga trupi gjykues, nga publiku, nga kryetari i gjykatës, nga kancelari i gjykatës apo kushdo tjetër. Ligji ka zgjedhur që sekretari, si figurë procedurale gjyqësore, të mos jetë në varësi as të gjyqtarit e as të kryetarit të gjykatës, për sa kohë ushtron veprimtarinë brenda sallës së gjykimit, gjatë një procesi gjyqësor. Ky element është shumë i rëndësishëm, sepse shërben si element bazë garantues i transparencës, i besimit të palëve ndaj gjykimit dhe i drejtësisë në përgjithësi.

- Procedurat e organizimit të shpërndarjes së çështjeve me short te gjyqtarët konkretë do të rregullohen, sipas ligjit, me vendim nga KLD-ja, e cila konsiderohet si organi që realizon vetëqeverisjen e gjyqësorit.

Subjekti i interesuar, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, mban qëndrimin se kërkesa është e bazuar për arsye se:

- Pavarësia e gjyqësorit cenohet edhe vetëm duke njohur me ligj mundësinë për ndërhyrje në veprimtarinë e organeve gjyqësore. Është vendosur një lidhje direkte mes administratës gjyqësore dhe pushtetit ekzekutiv, pasi kancelari i gjykatës ka varësi direkte nga Ministria e Drejtësisë.

- Pavarësia e gjyqtarëve perceptohet si pavarësi e gjykatave dhe këtu administrata ka një rol vendimtar, pa të cilin nuk mund të ushtrohet veprimtaria gjyqësore. Dispozitat, objekt i këtij gjykimi kushtetues, përjashtojnë kryetarin e gjykatës nga rekrutimi dhe largimi i stafit administrativ dhe nga mbikëqyrja e procedurave të ndarjes së çështjeve me short. Pozicioni i ri që kancelari dhe administrata gjyqësore kanë marrë me ligjin, objekt i këtij gjykimi kushtetues, është në kundërshtim me parimin e pavarësisë së gjyqësorit, pasi administrata gjyqësore, në kuadrin e shërbimeve të saj ndaj publikut, ofron disa shërbime si dhënie informacioni apo aktesh, dhe veprimtaria e saj bazë zhvillohet brenda procesit gjyqësor apo e lidhur me të.

- Pavarësia funksionale e gjyqësorit humbet kur procesi i ndarjes së çështjeve gjyqësore me short i besohet totalisht administratës. Kjo do të thotë se klasifikimi dhe vlerësimi i mundshëm i konflikteve, sipas dhomave të gjykimit apo seksioneve brenda dhomës civile, do të bëhet prej administratës.

- Karta Europiane për Statusin e Gjyqtarit e Këshillit të Europës përcakton se shteti ka detyrimin për t'iu siguruar gjyqtarëve të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e detyrave të tyre, në veçanti lidhur me çështjet gjyqësore dhe brenda një kohe të arsyeshme.

II

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit

1. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi, parashtrori se kërkuari nuk legjitimohet në këtë gjykim kushtetues, për shkak të subjektit konkret që ai përfaqëson (*ratione personae*), si dhe për shkak të mungesës së lidhjes ndërmjet interesit të tij të drejtpërdrejtë me thelbin e çështjes në gjykim (*ratione materiae*).

2. Kërkuari pretendoi se legjitimohet në kërkesën e tij, sipas objektit të këtij gjykimi kushtetues, për arsye se neni 134 shkronja “f” i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje nga organizata të tjera. SHKGGJ, sipas statutit të saj, synon mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor.

3. Gjykata vëren se, në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës, kërkuari legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, për arsye se SHKGGJ është një organizatë në kuptimin që e përdor neni i sipërcituar i Kushtetutës, regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2160, datë 25.1.2008. Në nenin 1 të statutit të Shoqatës është parashikuar se një ndër qëllimet kryesore të saj është “konsolidimi, forcimi dhe mbrojtja e pavarësisë së gjyqtarëve dhe e sistemit gjyqësor në tërësi”.

4. Kërkuari legjitimohet *ratione materiae*, në lidhje me pretendimin e tij për antikushtetutshmërinë e neneve të kundërshtuara të ligjit, objekt shqyrtimi, në këndvështrim të neneve 7 dhe 145, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës.

Gjykata ka theksuar edhe më parë se, në kuptim të nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, për gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve normative, subjektet që parashikohen në këtë dispozitë, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe pretendimit për shkelje kushtetuese në çështjen e ngritur. Shoqatat (organizatat e tjera) janë parashikuar në nenin 134 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës, ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.35, datë 10.10.2007 dhe nr.17, datë*

25.07.2008). Për të vlerësuar legjitimitimin e subjektit, Gjykata përcakton fillimisht të drejtën kushtetuese të subjektit, që pretendohet se i është cenuar nga norma konkrete e kundërshtuar para saj. Subjektet e parashikuara në nenin 134 pika 2 të Kushtetutës legjitimohen të kërkojnë antikushtetutshmërinë e normës juridike në qoftë se vetë norma ka cenuar ndonjë të drejtë a liri kushtetuese nga ato që subjekti legjitimohet t'i mbrojë para Gjykatës Kushtetuese. Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi pretendon se ligji i kundërshtuar ka cenuar, në përmbajtje, standardet kushtetuese që kanë të bëjnë me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe, në veçanti, me pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Pavarësia e gjyqësorit është element thelbësor dhe një ndër arsytet e themelimit të SHKGGJ-së. Duke qenë se ekziston lidhja e domosdoshme ndërmjet veprimtarisë që kërkuesi kryen dhe çështjes kushtetuese të ngritur prej tij, kjo shoqatë legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese lidhur me pretendimet e paraqitura para saj në objektin e kërkesës.

III

B. Lidhur me pretendimet për themelin

1. Kërkuesi pretendon se nenet 37, pika 2, dhe 38, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr.9877, cenojnë parimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 4, pika 2; 7 dhe 145, pika 1 dhe 3 të Kushtetutës. Gjykata, kushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara e vlerëson pasi të ketë sqaruar kuptimin dhe përmbajtjen e parimeve kushtetuese të referuara nga kërkuesi.

2. Në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës deklarohet parimi i shtetit të së drejtës. Ky parim është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës, që lidhen me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues, janë parimi i ndarjes së pushteteve dhe, i lidhur me këtë parim, ai i pavarësisë së gjyqësorit, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës dhe parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.20, datë 11.7.2006; nr.34, datë 20.12.2005*). Pavarësia e gjyqësorit është një nga shtyllat qendrore të shtetit të së drejtës për shkak të pozicionit që zë dhe rolit që luan gjyqësori në një shoqëri demokratike.

3. Parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve deklarohet në nenin 7 të Kushtetutës, sipas të cilit “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”. Ky formulim do të thotë që ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Çdo institucion i secilit pushtet gëzon kompetencën sipas këtij qëllimi. Përmbajtja konkrete e kësaj kompetence varet nga fakti se cilit pushtet i përket institucioni, nga vendi i tij midis institucioneve të tjera, nga raportet e tij me ato të institucioneve të pushtetit shtetëror. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 2.4.2008; nr.19, datë 3.5.2007*).

4. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj (neni 135 pika 1 i Kushtetutës). Gjykata ka konfirmuar më parë se gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 02.04.2008). Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohej të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 27.5.2004*).

5. Në nenin 145 të Kushtetutës deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (neni 145 pika 1 i Kushtetutës). Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të tillë është, që ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të

drejtat dhe liritë e njeriut. Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, varësia absolute e gjyqtarit ndaj ligjit është kushti dhe legjitimimi i kësaj pavarësie. Pavarësia e gjyqësorit e presupozon vetëqeverisjen e tij. Kjo vetëqeverisje përfshin edhe organizimin e punës në gjykatë dhe aktivitetet e trupave gjyqësorë. Për këtë qëllim, gjykatat kanë dhe buxhet të veçantë, të cilin e administrojnë vetë (neni 144 i Kushtetutës), duke parashikuar në këtë mënyrë një autonomi në administrimin e financave nga vetë ato.

6. Kushtetuta e ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe gjyqtarëve në nenin 145 pika 3, ku parashikohet se “Ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave ose të gjyqtarëve passjell përgjegjësi sipas ligjit”. Termi “veprimtari” është i lidhur me funksionin e drejtësidhënies nga gjykatat. Kështu, kjo normë e Kushtetutës ngarkon institucionet dhe pushtetet e tjera me detyrën kushtetuese që të respektojnë pavarësinë e gjyqtarëve dhe të gjykatave, duke vendosur një detyrim negativ mbi to në kuptim të mosndërhyrjes lidhur me kompetencën ekskluzive të gjyqtarëve dhe gjykatave për dhënien e drejtësisë, nëpërmjet zgjidhjes së çështjeve konkrete.

7. Parimi i pavarësisë së gjyqtarëve është gjithashtu i përfshirë në një sërë dokumentesh ndërkombëtare: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), Parimet Bazë për Pavarësinë e Gjyqësorit, miratuar nga Asambleja e OKB-së, Rekomandimi për Pavarësinë, Efiçencën dhe rolin e gjyqtarëve, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, Karta Universale e Gjyqtarit etj. Këto dokumente ndërkombëtare, në tërësi, identifikojnë parimet bazë të pavarësisë së gjyqësorit si p.sh.: se gjyqtari duhet të ketë autoritetin për të vendosur për çështjet i lirë nga çdo ndërhyrje; ndarja e pushteteve dhe pavarësia e gjyqësorit të përfshihen në rendin kushtetues; gjykatat dhe gjyqtarët duhet të kenë pavarësi administrative dhe të përfshihen në procesin buxhetor; mbrojtja e gjyqtarëve nga shfuqizimi arbitrar ose rishikimi i vendimeve të tyre duhet të jetë i garantuar; pavarësia ndërinstitucionale, që është e drejta e gjyqtarëve për të marrë vendime pa ndërhyrje të papërshtatshme nga gjykatat më të larta etj.

8. Elementet e parimit të pavarësisë së gjyqësorit janë trajtuar dhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në kuadrin e nenit 6 të KEDNJ, i cili përfshin të drejtën për t’iu drejtuar një gjykate të pavarur e të paanshme. Kështu, GJEDNJ shpreh se, me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, duhet konsideruar, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve dhe kohëzgjatja e funksionit, ekzistenca e garancive jashtë presioneve të jashtme dhe çështja nëse organi paraqet një shfaqje të pavarësisë. Pavarësia kërkon edhe një ndarje të mjaftueshme nga pushteti ekzekutiv (*Çështja Bryan k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i GJEDNJ, 22 nëntor 1995; Sramek k. Austria, vendim i GJEDNJ 22 tetor 1984*).

9. Gjykata, më poshtë, vlerëson kushtetutshmërinë e neneve të kundërshtuara nga kërkuesi, duke pasur parasysh kuptimin dhe përmbajtjen e parimeve kushtetuese të sqaruara më lart.

a) Lidhur me pretendimin se neni 38 shkronja “a” i ligjit të kundërshtuar, cenon parimet kushtetuese të përmendura më sipër

10. Në nenin 38 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” parashikohen kompetencat e kancelarit. Kjo dispozitë, në shkronjën “a” parashikon: *“Kancelari i gjykatës ka këto kompetenca kryesore: a) emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës;...”*. Ligji i mëparshëm që rregullonte organizimin e pushtetit gjyqësor (ligji nr.8436, i ndryshuar me ligjin nr.8546), i shfuqizuar nga ligji i cituar më sipër, lidhur me kompetencat e kancelarit, në nenin 14/b, ndër të tjera, bënte këtë rregullim: *“...3. Emërimi dhe shkarkimi i sekretarëve gjyqësorë dhe i personelit administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës bëhet nga kryetari i gjykatës, me propozim të kancelarit”*.

11. Kërkuesi dhe subjekti i interesuar, KLD-ja, pretendojnë se përjashtimi i kryetarit të gjykatës nga procesi i emërimit dhe i shkarkimit të personelit të shërbimeve ndihmëse në gjykatë cenon parimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Sipas tyre, me pozicionin e ri që kancelari dhe administrata gjyqësore kanë marrë sipas ligjit, objekt i këtij gjykimi kushtetues, administrata gjyqësore vihet nën varësinë vertikale të Ministrit të Drejtësisë, sepse kancelari i gjykatës është nën varësinë direkte të Ministrit. Pavarësia e gjyqtarëve perceptohet si pavarësi e gjykatave dhe këtu administrata ka një rol vendimtar, pa të cilin nuk mund të ushtrohet veprimtaria gjyqësore.

12. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, në kundërshtimet e tyre, mbajnë qëndrimin se rregullimi i ri, që ka bërë ligji në nenin 38/a, nuk cenon pavarësinë e gjyqësorit, pasi termi “pavarësi” i referohet gjyqtarit ose trupit gjykues, në rastin e çështjes konkrete, kur gjyqtari jep

vendimin, pra ushtron funksionin e dhënies së drejtësisë. Linja logjike që përshkon në tërësi ligjin nr.9877 është realizimi i një ndarjeje të pastër, reale dhe pa asnjë konfondim midis dy veprimtarive në ambientet e gjykatës: funksioni i gjyqësisë (i dhënies së drejtësisë) dhe veprimtaria mbështetëse në shërbim të gjyqtarëve dhe në shërbim të publikut. Këto janë dy veprimtari të ndryshme që nuk pengojnë njëra-tjetrën, dhe për rrjedhojë nuk ka nevojë dhe nuk është e domosdoshme krijimi i marrëdhënieve të varësisë hierarkike midis tyre.

13. Siç Gjykata shpjegoi edhe më lart, neni 145/ 1 i Kushtetutës shprehet për gjyqtarë të pavarur, ndërsa neni 42/1 deklaron të drejtën e çdokujt për t'iu drejtuar një gjykate të pavarur. Kushtetuta e ndalon ndërhyrjen në veprimtarinë e gjykatave dhe gjyqtarëve (neni 145, pika 3). Termi “veprimtari” është i lidhur me funksionin e drejtësidhënies nga gjykatat. Në këtë frymë duhet lexuar edhe neni 144 i Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat e administrojnë vetë buxhetin e tyre. Në këtë kuptim, Gjykata ripohon qëndrimin se, në kuptim të Kushtetutës, pavarësia e gjyqësorit përfshin pavarësinë e gjyqtarit dhe të gjykatës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 2.4.2008*).

14. Kushtetuta, në dallim nga ligji nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, në të cilin përcaktohej se administrata gjyqësore varet nga Ministri i Drejtësisë (neni 29), nuk ka bërë një rregullim të veçantë për administratën gjyqësore. Gjykata, duke pasur parasysh frymën dhe përmbajtjen e neneve 7, 42, 144 dhe 145 të Kushtetutës çmon se roli dhe funksionimi i administratës gjyqësore nuk mund të ndahet nga funksioni i dhënies së drejtësisë dhe përbën një element të rëndësishëm të pavarësisë organizative të pushtetit gjyqësor (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 3.5.2007*). Në këtë kuptim, Kushtetuta nuk e lejon vendosjen e administratës gjyqësore nën varësinë e Ministrit të Drejtësisë dhe as nuk i njeh këtij të fundit një rol parësor në organizimin dhe drejtimin e këtij shërbimi.

15. Pushtetet, siç Gjykata u shpreh dhe më lart, megjithëse janë të ndarë dhe të pavarur në ushtrimin e detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta balancojnë njëri-tjetrin duke respektuar, nxitur, mbështetur dhe kontrolluar njëri-tjetrin. Ndërhyrja në funksionimin e gjykatave, si instrument i balancës, duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave të mos shkelet. Duke u nisur nga ky kuptim, Gjykata vlerëson nëse kompetenca që ligji i njeh kancelarit për të emëruar dhe shkarkuar personelin e administratës gjyqësore respekton apo jo kufijtë ndërmjet pavarësisë dhe balancës së gjyqësorit. Në këtë drejtim, fillimisht duhet pasur parasysh pozita e kancelarit dhe roli i administratës gjyqësore sipas ligjit.

16. Kancelari, në gjykatën ku ushtron funksionin, është nëpunësi më i lartë i administratës gjyqësore. Ai drejton dhe përgjigjet për shërbimet ndihmëse në Gjykatë (neni 37/1). Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë (37/2). Ligji, për një kandidat që të mund të emërohet kancelar kërkon dy kushte: të jetë diplomuar jurist dhe të ketë përvojë pune jo më pak se pesë vjet në këtë profesion (neni 37/3). Përsa i përket shkarkimit të kancelarit, ligji nuk parashikon rastet dhe procedurën që duhet të ndjekë Ministri për ushtrimin e kësaj kompetence. Nëpërmjet këtyre rregullimeve, ligji e vendos kancelarin në një raport të drejtpërdrejtë varësie dhe kontrolli nga Ministri i Drejtësisë. Fakti i mosparashikimit të kriterëve dhe motiveve për rastet e shkarkimit të kancelarit nuk krijon garancitë e nevojshme që do të kërkonte ushtrimi i detyrës nga ai. Gjykata e çmon të nevojshme të theksojë se, pavarësisht se ligji nuk parashikon kriteret dhe procedura për shkarkimin, kjo nuk e shmang Ministrin e Drejtësisë nga detyrimi për të zbatuar kriteret transparente, të bazuara vetëm në kërkesa profesionale dhe etike, dhe jo në motive politike. Ky detyrim rrjedh nga parimi kushtetues për respektimin pavarësisë së gjyqësorit.

17. Në bazë të ligjit nr.9877 objekt shqyrtimi, shërbimet ndihmëse në gjykatë kryhen nga sekretaria gjyqësore, degët dhe sektorët e administratës, të ekonomisë, financës, informatizimit, regjistrimit dhe ruajtjes së dokumenteve (neni 39). Disa nga këto shërbime të administratës gjyqësore kryejnë edhe veprimtari të natyrës procedurale penale, civile ose administrative, të cilat janë pjesë e pandarë e një procesi të rregullt ligjor. Sekretari i gjykatës kryen funksione të rëndësishme të sqaruara në Kodin e Procedurës Penale (KPP) dhe Kodin e Procedurës Civile (KPC). Kështu, sipas kreut II të KPP-së mbi “Njoftimet”, sekretaria ruan sendet e sekuestruara (neni 214), apo mban procesverbalet e seancës, sipas parashikimeve të nenit 345 të KPP. Sipas KPC-së, roli dhe detyrat e sekretarit gjyqësor (neni 77) janë dokumentimi për të gjitha efektet e veprimtarive të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve në proces. Sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal. Ai lëshon kopje dhe ekstrakte autentike të dokumenteve të përpiluara, regjistron çështjet në dorë, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit, dhe shënon

menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor. Edhe nëpunësi gjyqësor merr pjesë në seancë gjyqësore dhe merr masa për zbatimin e urdhrave, ndjek procedurën e njoftimit të akteve dhe kryen detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor (neni 78). Siç rezulton nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme, shërbimet ndihmëse në gjykatë luajnë një rol të rëndësishëm mbështetës për gjykatën dhe gjyqtarin në dhënien e drejtësisë.

18. Në frymën e dispozitave të Kushtetutës për pavarësinë e gjyqësorit dhe ndarjen e pushteteve, pushteti ekzekutiv, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, duhet ta konsiderojë si detyrë të tij garantimin e kushteve të përshtatshme të punës për gjykatat dhe gjyqtarët, në funksion të dhënies së drejtësisë. Ndërsa “kontrolli” si i tillë nuk duhet të cenojë elementet e pavarësisë, të cilat në thelb prekin vetë funksionin e dhënies së drejtësisë.

19. Gjykata, bazuar në analizën e dispozitave të përmendura më sipër, vëren se ligji jo vetëm që nuk i ngarkon kryetarët e gjykatave me përgjegjësi të drejtpërdrejtë për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore, por nuk i njeh as instrumentet e duhura ligjore, të cilat do të bënin të mundur drejtimin dhe kontrollin e shërbimeve ndihmëse në gjykatë. Shmangia e drejtuesve të gjykatave nga kjo përgjegjësi nuk shkon në mënyrë harmonike me kushtet që kërkohen për t’u zgjedhur kryetar (neni 16) ku, ndër të tjera, kërkohet që kandidati të ketë “aftësi organizative dhe menaxhuese”. Skema e varësisë hierarkike Ministër Drejtësie – kancelar – administratë gjyqësore, që parashikon ky ligj, sipas Gjykatës, mund të rezultojë në një situatë ku veprimtaria e gjykatës të varet nga veprimet e kancelarit, i cili emërohet dhe shkarkohet pa kritere të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë.

Siç u theksua dhe më lart, parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe fryma e Kushtetutës pranojnë bashkëpunim dhe bashkëveprim ndërmjet gjyqësorit dhe ekzekutivit lidhur me çështjet e administratës gjyqësore, por kjo duhet të organizohet në mënyrë të tillë që pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave të mos shkelet.

20. Gjykata çmon se duke pasur parasysh kuptimin e pavarësisë organizative të gjykatave, si shprehje e pavarësisë së gjyqësorit, shmangia e kryetarëve të gjykatave nga çështjet që lidhen me organizimin, drejtimin dhe kontrollin e përgjegjshmërisë së administratës gjyqësore, si dhe me emërimin dhe shkarkimin e personelit, krijon rrezikun e një ndikimi të papërshtatshëm në funksionin ekskluziv të gjyqësorit, dhënien e drejtësisë, si dhe i vendos strukturat brenda gjykatave në kushte të papërshtatshme për krijimin e marrëdhënieve të besimit, të cilat janë të nevojshme për ushtrimin normal të funksionit.

21. Gjykata e vlerëson kompetencën e kancelarit për emërimin dhe shkarkimin e personelit administrativo-teknik, edhe në drejtim të ndikimit që mundëson kjo kompetencë në çështjet e administrimit financiar. Personeli i sektorit të financave është pjesë e personelit të shërbimeve ndihmëse në gjykatë. Kompetenca e kancelarit për të emëruar dhe shkarkuar edhe personelin e sektorit të financave, duke shmangur kryetarin e gjykatës, e vendos këtë sektor në vartësi të drejtpërdrejtë të tij. Për rrjedhojë, ky rregullim bie në kundërshtim me nenin 144 të Kushtetutës, sipas të cilit gjykatat e administrojnë vetë buxhetin e tyre (neni 40/1 i ligjit nr.9877).

22. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se neni 38/a i ligjit nr.9877, ku parashikohet se: “*kancelari emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativ teknik, ...*” bie në kundërshtim me standardet e mësipërme kushtetuese lidhur me pavarësinë e gjykatave dhe të gjyqtarëve, lexuar së bashku me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.

b) Lidhur me pretendimin se neni 38 shkronja “b” i ligjit të kundërshtuar cenon parimet kushtetuese të përmendura më sipër

23. Në nenin 38 të ligjit nr.9877, ku përcaktohen kompetencat e kancelarit, në shkronjën “b” parashikohet: “*Kancelari i gjykatës...: b) mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore të gjyqtari i caktuar;...*”.

Kërkuesi dhe subjekti i interesuar, KLD-ja, pretendojnë se kjo kompetencë e kancelarit për të mbikëqyrur dhe organizuar shortin është një ndërhyrje joobjektive dhe e pajustificuar në veprimtarinë e përditshme të gjykatave, të gjyqtarëve dhe të pushtetit gjyqësor në tërësi.

24. Gjykata, lidhur me këtë kompetencë të kancelarit, të parashikuar nga neni 38/b i ligjit objekt shqyrtimi, vëren se ligji parashikon se ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short sipas procedurave të caktuara me vendim të KLD-së (neni 9). Gjykata është shprehur se Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka detyrën për të realizuar “vetëqeverisjen” e gjyqësorit dhe, sipas neni 147 të Kushtetutës, është organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar

vetëqeverisjen e gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tilla, realizojnë lidhjen me korpusin gjyqësor. Frymën e vetëqeverisjes në Këshillin e Lartë të Drejtësisë kushtetutbërësi e ka përfshirë me qëllimin për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e çdo pushteti tjetër (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 2.4.2008; nr.14, datë 22.5.2006*).

25. Gjykata vlerëson se në këtë rast, roli i kancelarit është thjesht mbikëqyrës i procedurave të caktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ky parashikim është në thelb një aspekt i kontrollit të pushtetit ekzekutiv ndaj gjyqësorit dhe, sipas Gjykatës, përfaqëson një mekanizëm të përshtatshëm në përputhje me parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve. E rëndësishme është që procedura të rregullohet në mënyrë të tillë që të shmangë influencën në shpërndarjen e çështjeve nga ndonjë palë, nga administrata, nga qeveria ose nga çdo person tjetër, të cilit i intereson rezultati i çështjes.

26. Për sa më sipër, Gjykata, pretendimin e kërkuar se kompetenca e kancelarit për të mbikëqyrtuar procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, sipas nenit 38/b, cenon parimet kushtetuese të parashikuara nga nenet 4, pika 2; 7 dhe 145, e çmon të pabazuar.

c) Lidhur me pretendimin se neni 37 pika 2 i ligjit të kundërshtuar, cenon parimet kushtetuese të përmendura më sipër

27. Në nenin 37 të ligjit nr.9877, në pikën 2 parashikohet: “Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.”. Ligji i mëparshëm që rregullonte organizimin e pushtetit gjyqësor (ligji nr.8436, i ndryshuar me ligjin nr.8546), i shfuqizuar nga ligji objekt i këtij shqyrtimi kushtetues, në nenin 14/b bënte të njëjtin rregullim si dispozita e cituar më sipër.

28. Kërkuar dhe subjekti i interesuar, KLD-ja, pretendon se kjo kompetencë e Ministrit të Drejtësisë për të emëruar kancelarin pa kritere të qarta dhe të plota dhe sidomos për ta shkarkuar atë pa qenë i kufizuar nga kritere ligjore objektive dhe pa pjesëmarrjen e ndonjë organi tjetër në këtë proces, bie ndesh me parimet kushtetuese të referuara më sipër, me parimet e depolitizimit, meritokracisë dhe palëvizshmërisë së punonjësve të administratës publike në përgjithësi dhe sidomos të pushtetit gjyqësor.

29. Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, lidhur me këtë pretendim, nuk arriti të marrë një vendim me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, sipas nenit 133 të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, Gjykata, bazuar në nenin 74 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, lidhur me pretendimin për jokushtetutshmërinë e nenit 37/2 të ligjit objekt shqyrtimi, vendosi të refuzojë kërkesën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “a”; 134 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të shprehjes, në nenin 38 shkronja “a” të ligjit nr.9877: “a) emëron dhe shkarkon personelin e sekretarisë gjyqësore dhe personelin administrativo-teknik të shërbimeve të gjykatës”;

- Rrëzimin e kërkesës lidhur me pretendimin për jokushtetutshmërinë e shprehjes në nenin 38 shkronja “b” të ligjit nr.9877: “ b) mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore të gjyqtari i caktuar”.

- Refuzimin e kërkesës lidhur me pretendimin për jokushtetutshmërinë e shprehjes në nenin 37, pika 2, të ligjit nr.9877: “Kancelari emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë.”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e shpalljes.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Sokol Sadushi

VENDIM
Nr.26, datë 24.7.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 7.04.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 Akti, që i përket:

KËRKUES: Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Sandër Simoni dhe z. Luan Hasneziri, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

Ministria e Financave, e përfaqësuar nga znj. Mimoza Dhëmbi, me autorizim.

Ministria e Drejtësisë, e përfaqësuar nga z. Miran Kopani dhe z. Gazmend Bardhi.

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën i fjalisë “Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë” dhe i fjalisë “Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind”, të nenit 26/2, të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 131 shkronja “a”, 134 shkronja “f” dhe 138 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 49 e 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë që kërkuan pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave që kërkuar rrëzimin e saj, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr.9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me të cilin është parashikuar krijimi, organizimi dhe kompetencat e gjykatave, kushtet dhe procedurat për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, të drejtat dhe detyrimet e gjyqtarëve, masat disiplinore dhe procedura për shkarkimin e tyre, si dhe çështje të tjera të lidhura me funksionimin e gjykatave. Në kreun IV të tij janë përcaktuar rregullat bazë që lidhen me statusin e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, përfshirë këtu edhe paga e tyre. Në nenin 26, pika 2 të tij është sanksionuar se “paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas 5 vjet vjetërsie në shërbim, siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji, për çdo vit vjetërsi, kjo pagë, deri në 25 vjet shërbim, shtohet me 2 për qind në vit. Njëkohësisht në këtë dispozitë është parashikuar se “mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind”.

Përpara daljes së këtij ligji, paga e tyre ka qenë e rregulluar me ligjin nr. 9110, datë 24.7.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda". Në nenin 9 të tij parashikohet se "përveç të drejtave dhe garancive të njohura me ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda gëzojnë edhe këto të drejta e garanci: a) pagë të veçantë, sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij ligji; b) shpërblim të posaçëm mbi pagë të barabartë me një pagë mujore për periudhën e lejes". Ndërkohë, lidhja nr. 1 e këtij ligji përcaktonte se paga e kryetarit të gjykatës që krimeve të rënda ishte e barabartë me 70% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë, ndërsa paga e gjyqtarit ishte e barabartë me 60% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë. Edhe sistemi i pagës për gjykatat e apelit për krimet e rënda i referohej, sipas një përqindje konkrete, pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë.

2. Kërkuesi ka pretenduar se ulja e pagës së gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda, nga 60% të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në masën 50 % të pagës së tij, që parashikohet në nenin 26, pika 2 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" vjen në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës, në të cilin sanksionohet se "Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen".

Nëpërmjet rregullit përjashtimor të parashikuar në nenin 43, pika 5 të ligjit, janë kijuar diferencime të paarsyeshme në pagë ndërmjet gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda, për arsye se nga njëra anë gjyqtarëve në detyrë iu ruan nivelin e mëparshëm të pagës prej 60 % të anëtarit të Gjykatës së Lartë, ndërsa gjyqtarët e rinj i paguan me 50 % të kësaj page.

3. Përfaqësuesi i Kuvendit, në parashtrimin e tij me shkrim, dërguar në Gjykatën Kushtetuese ka pretenduar se:

- Kërkuesi nuk legjitimohet për arsye se nuk ka tagër që të flasë në emër dhe për të gjithë trupën e gjyqtarëve që janë subjekte të ligjit të kundërshtuar.

- Kërkuesi nuk jep argumente juridike mbi antikushtetutshmërinë e dispozitës ligjore që parashikon pagat e gjyqtarëve. Pranimi i kërkesës do të sillte një boshllëk ligjor dhe, për pasojë, në rastin më të mirë gjyqtarët e gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda do të marrin një pagë të barabartë me kolegët e tyre të shkallës së parë, ndërsa në rastin më të keq nuk do të kishte instrumente juridike për të marrë pagën e tyre.

4. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se:

- Kërkuesi nuk legjitimohet për të iniciuar një gjykim të kontrollit abstrakt të normës ligjore, për shkak se subjekte të tillë, në respekt të Kushtetutës dhe të ligjit kanë detyrimin të argumentojnë lidhjen e çështjes me interesat e tyre, e cila nuk rezulton të jetë bërë përmes kësaj kërkesë;

- Qëllimi i parashikimit të nenit 138 të Kushtetutës është garantimi i pavarësisë së gjyqtarëve nga cenime eventuale gjatë kohës që ata janë duke ushtruar detyrën e tyre dhe jo nëpërmjet rregulimeve të reja ligjore që shtrijnë efektet e tyre mbi gjyqtarët që do të emërohen në të ardhmen;

- Kërkuesi nuk i referohet nenit 43/5 të ligjit, objekt shqyrtimi, i cili përbën thelbin e moscenimit të pagës së gjyqtarëve dhe bazën juridiko-kushtetuese për rrëzimin e kësaj kërkesë.

5. Subjekti i interesuar, Ministria e Financave, ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se:

- Reforma në sistemin e pagave të gjyqësorit, e ndërmarrë në vitin 2008, ishte pjesë e pandarë e reformës së përgjithshme për përmirësimin e strukturës dhe kategorizimin e pagave në sistemin buxhetor, me qëllim modernizimin dhe standardizimin e këtij sistemi.

- Për të shmangur rënien e pagës bruto të gjyqtarit, e cila prekte vetëm një pjesë të tyre, ligjvënësi ka parashikuar në nenin 43 të këtij ligji moscenimin e pagës aktuale të gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e cila zbatohet edhe për ata gjyqtarë që përfundojnë mandatin 9-vjeçar në gjykatën e krimeve të rënda dhe emërohen në detyra të tjera brenda sistemit gjyqësor.

6. Subjekti i interesuar, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në materialin e saj me shkrim, dërguar Gjykatës Kushtetuese për çështjen në shqyrtim, nuk është shprehur lidhur me objektin e kërkesës, por ka arsyetuar se argumentet financiare që janë parashtruar nga kërkuesi janë korrekte, përsa i përket përlllogaritjeve të bëra për përcaktimin e pagës së gjyqtarëve të gjykatës për krimet e rënda përpara dhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

II

1. Lidhur me pretendimin e subjektit të interesuar për moslegjitimimin e kërkesit.

Subjektet e interesuara, Kuvendi i Shqipërisë dhe Ministria e Drejtësisë, kanë pretenduar se kërkesi nuk duhet të legjitimohet, pasi ai nuk ka tagër të flasë në emër të të gjithë gjyqtarëve dhe, se ligji i kundërshtuar nuk cenon interesat e tij. Çështjen e legjitimitetit të kërkesit, (*locus standi*) Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e vlerëson si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet inicuese që parashikohen në nenin 134, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Shoqatat, që përfshihen në subjektin kushtetues “organizatat e tjera” janë të specifikuar në nenin 134, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkëta.” (Shih vendimin nr.35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata vlerëson se kërkesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134, shkronja “f” të Kushtetutës dhe neni 49, pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Ai është një subjekt juridik i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.2171 datë 4.2.2008. Në Statutin e Shoqatës, neni 1 parashikon se “Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, vullnetare, e pavarur, profesionale, e cila bashkon gjyqtarë shqiptarë dhe kontribuon në mbrojtjen e interesave të tyre profesionale, shoqërore, intelektuale, materiale, si dhe në forcimin e një imazhi publik pozitiv për gjykatat shqiptare”. Siç rezulton edhe nga vendimi për regjistrimin si person juridik, anëtarët e shoqatës janë gjyqtarë të të gjitha shkallëve të gjyqësorit të zakonshëm. Gjithashtu, neni 8 i Statutit të kësaj Shoqate parashikon se “Duke bashkuar gjyqtarët, shoqata ka për qëllim të ndihmojë në mbrojtjen e interesave të tyre ... materiale; të forcojë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si dhe të përsosë dhe konsolidojë pozitën e balancuar të pushtetit gjyqësor në raport me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv”.

2. Lidhur me pretendimin e kërkesit për cenimin e nenit 138 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkesi pretendon se neni 26, pika 2 e ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka cenuar një standard të rëndësishëm kushtetues që lidhet me paprekshmërinë e pagës së gjyqtarit. Neni 138 i Kushtetutës parashikon se “Koha e qëndrimit të gjyqtarëve në detyrë nuk mund të kufizohet; paga dhe përfitimet e tjera të tyre nuk mund të ulen”. Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik. Nëpërmjet ushtrimit të funksionit të drejtësisë, gjyqtari dhe gjykatat duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, në ligje dhe në akte të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Gjykata thekson se parimi i pavarësisë së gjyqësorit përfshin një gamë të gjerë aspektesh, të cilat të marra së bashku krijojnë kushtet e nevojshme që gjykatat të përmbushin rolin dhe detyrat e tyre, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Garancitë kushtetuese që lidhen me palëvizshmërinë e gjyqtarëve, si dhe me paprekshmërinë e pagës e të përfitimeve të tjera, për shkak të funksionit, kanë ndikimin e tyre që gjyqtari të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur. Siguria në lidhje me pagën dhe me ushtrimin e qëndrueshëm të detyrës krijojnë kushtet e nevojshme që gjyqtarët të zbatojnë ligjin në mënyrë të drejtë e të paanshme. Vlerësimi i sistemit të garancive dhe pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave janë ngushtësisht të ndërlidhura ndërmjet tyre (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 2.4.2008). Garancitë kushtetuese për statusin e gjyqtarit lidhen me emërimin, paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e tyre nga detyra pa shkaqe të përligjura, me mosndjekjen e tyre penalisht dhe disiplinarisht pa vendim të motivuar të KLD-së, si dhe me garancitë financiare”(Shih më gjerë vendimin nr.11, datë 27.5.2004 të Gjykatës Kushtetuese). Gjyqtari, i cili është i detyruar të marrë në shqyrtim konfliktet që ngrihen ndërmjet individëve, si dhe mes tyre dhe shtetit, jo vetëm që duhet të ketë kualifikimet më të larta profesionale dhe një reputacion të mirë, por duhet gjithashtu të jetë edhe financiarisht i pavarur. Shteti ka detyrimin të vendosë paga të tilla për gjyqtarët, të cilat do të jenë në përputhje me statusin e gjyqtarit dhe të gjyqësorit, funksionet e ushtruara prej tyre dhe përgjegjësitë përkatëse. “Gjyqtarët që ushtrojnë funksione gjyqësore në pozitë profesionale kanë të drejtë për pagë,

niveli i të cilës fiksohet që t'i mbrojnë ata nga presionet që synojnë të influencojnë vendimet e tyre, dhe më në përgjithësi sjelljen e tyre brenda juridiksionit të tyre” (shih Kartën Europiane mbi Statutin për Gjyqtarët (Këshilli i Europës DAJ/DOC (98) 23).

Gjykata vlerëson se gjyqtarët duhet të marrin pagesë për shërbimin e tyre në një nivel të përshtatshëm në raport me pagën e zyrtarëve të tjerë publikë, e cila duhet të jetë në përpjesëtim me statusin e tyre dhe e paprekshme për sa kohë që ata janë duke ushtruar detyrën e gjyqtarit. Gjyqtari duhet të marrë një pagë të mjaftueshme për të siguruar një pavarësi të vërtetë ekonomike, e cila nuk duhet të varet nga rezultatet e punës dhe që nuk mund të ulët gjatë qenies së tij në detyrë.

Standardi kushtetues i papekshmërisë së pagës së gjyqtarëve, përbën një aspekt të rëndësishëm të shprehjes së pavarësisë së gjyqësorit, që në kuptim të nenit 138 të Kushtetutës vlerësohet nga Gjykata i detyrueshëm për t'u zbatuar vetëm ndaj gjyqtarëve që janë duke e ushtruar detyrën e tyre si të tillë.

Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se sistemi i ri i pagave i propozuar në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur një nivel standard në kategorizimin e pagës së gjyqtarit, si dhe një vlerësim të kontributit të çdo gjyqtari duke u mbështetur në vitet e shërbimit. Në ndryshim nga sistemi i mëparshëm, ligji i ri ka vendosur diferencimin e pagës për tre nivelet e gjyqësorit, duke vendosur edhe një sistem shpërblimi të karrierës brenda çdo niveli. Mbi këtë bazë, është përcaktuar një sistem i tillë, ku shpërblimi për vjetërsi në punë, mbas një periudhe të caktuar, e rrit pagën e gjyqtarit me 2% në vit, duke vendosur si tavan pagën e gjyqtarit të nivelit më të lartë. Sistemi është i ndarë në tre nivele, ku paga maksimale në një nivel nuk mund të jetë më e lartë se paga më e ulët në nivelin tjetër.

Rezulton se ligji i ri në nenin 26, pika 2 e ka ulur në dukje pagën bazë të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda nga 60% e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në 50% të pagë së tij. Gjykata vlerëson se një ndryshim i tillë në sistemin e pagave të pushtetit gjyqësor nuk prek në thelb pagën e gjyqtarit. Pikërisht, për shkak të ndërtimit të drejtë të sistemit të pagave të pushtetit gjyqësor, ligji ka parashikuar një shtesë prej 10 % mbi pagë për gjyqtarët e gjykatës së krimeve të rënda për shkak të kushteve të veçanta të punës, si dhe detyrimit për një nivel më të lartë page se në gjykatat e zakonshme.

Nisur nga koncepti kushtetues i papekshmërisë së pagës së gjyqtarit, ligjvënësi në “Dispozitat kalimtare” dhe konkretisht në nenet 43, pika 5 të ligjit objekt shqyrtimi ka parashikuar fillimin e efekteve financiare në datën 1 janar të vitit 2009, si dhe moscenimin e pagës aktuale të gjyqtarëve të gjykatës së krimeve të rënda si rrjedhojë e zbatimit të neneve 26 dhe 27 të ligjit.

Mbi këtë bazë, Gjykata vlerëson se dispozitat ligjore mbi pagat nuk e kanë cenuar pagën që përfiton gjyqtari në detyrë, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në këtë mënyrë, rezulton se papekshmëria e pagës së gjyqtarëve, në kuptimin kushtetues, është siguruar dhe përfitimet e sigurimeve shoqërore e të pensioneve shtetërore suplementare, nuk janë ulur, përderisa si pagë referuese në kuptim të këtij ligji konsiderohet paga që ka gjyqtari në momentin kur i lind kjo e drejtë. Një rregullim i tillë është në përputhje dhe me standardin kushtetues të parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës.

Lidhur me pretendimin tjetër të kërkuarit mbi trajtimin e pabarabartë që i bëhet nga dispozita ligjore objekt shqyrtimi, gjyqtarëve në detyrë dhe gjyqtarëve që do të mund të emërohen në të ardhmen, Gjykata thekson se kërkuari nuk arriti ta argumentojë atë në një nivel kushtetues. Nisur edhe nga interpretimi i sipërcituar që bëri Gjykata mbi zbatimin e konceptit të papekshmërisë së pagës vetëm për gjyqtarët në detyrë, në kuptim të nenit 138 të Kushtetutës, ky pretendim rezulton i pabazuar. Për rrjedhojë, kërkesa e paraqitur nga kërkuari duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131 shkronja “c” dhe 134, pika 1, shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të fjalisë “Paga bazë e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë të krimeve të rënda është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë” dhe të fjalisë “Mbi këtë pagë, për kushte të veçanta pune, shtohet 10 për qind”, të nenit 26/2 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (kryetar), Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Kujtim Puto, Fehmi Abdiu, Admir Thanza, Sokol Sadushi

VENDIM

Nr.1, datë 8.1.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Perikli Zaharia	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Evjeni Sinoimeri	Anëtare
Spiro Spiro	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Evelina Qirjako	Anëtare
Guxim Zenelaj	Anëtar
Majlinda Andrea	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Andi Çeliku	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 8.1.2009 morën në shqyrtim çështjen penale që i përket:

KËRKUESI: Rexhep Cuku, i biri i Osmanit, i datëlindjes 15.1.1960, lindur e banues në Tiranë, i padënuar, përfaqësuar nga avokat Ilir Murati.

OBJEKTI: Revokim i masës së sigurimit “Arrest në burg” dhe lirim të menjëhershëm të kërkuesit.

BAZA LIGJORE: Nenet 246 pika 6, 260 pika 1 dhe vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.94, datë 20.5.2008 ka vendosur:

“1.Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Rexhep Cuku, me objekt revokimin e masës së sigurimit si të pabazuar në prova të ligj”.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.31, datë 23.6.2008 ka vendosur:

“Lënia në fuqi të vendimit nr.94, datë 20.5.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda”.

Kundër vendimit nr.31, datë 23.6.2008 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, ka paraqitur rekurs kërkuesi

Rexhep Cuku, nëpërmjet mbrojtësit të tij, duke kërkuar ndryshimin e vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, revokimin e masës së sigurimit “arrest në burg” dhe lirim të menjëhershëm të kërkuarit ose zëvendësimin e asaj mase me një masë më të lehtë, për këto shkaqe:

- Në gjykimet e zhvilluara në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe atë të Apelit për Krime të Rënda është provuar se nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda nuk është marrë në pyetje i pandehuri, nuk janë kryer veprime të tjera të mëtijshme hetimore, ndërkohë që në gjendjen që janë aktet e tjera të këtij procedimi rezulton se nevojat e sigurimit për këtë të pandehur nuk ekzistojnë.

- Në gjykim është vërtetuar se nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda nuk është dërguar në gjykatë asnjë informacion mbi veprimet hetimore të kryera në lidhje me të arrestuarin, kërkuar Rexhep Cuku. Sa më sipër përbën shkelje të hapur të kërkesave të nenit 246 pika 6 të Kodit të Procedurës Penale. Si rrjedhojë e mospërmblidhjes, qoftë edhe vetëm të këtij detyrimi ligjor dhe pasojave që vijnë prej tij, vetvetiu, gjykatat ishin të detyruara të revokonin masën e sigurimit “arrest me burg” apo ta zëvendësonin atë me një masë tjetër më të lehtë. Sa më sipër, njëkohësisht përbën cenim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara në Kushtetutë dhe në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe të atyre që parashikohen në nenin 248 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 29.9.2008, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për të unifikuar praktikën gjyqësore.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Aleksandër Muskaj; prokurorin pranë Prokurorisë së Përgjithshme Bujar Sheshi, që kërkoj lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; mbrojtësin e të pandehurit Rexhep Cuku, avokatin Ilir Murati, i cili kërkoj ndryshimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në të dy shkallët e gjykimit, revokimin e masës së sigurimit arrest në burg dhe lirim të menjëhershëm të kërkuarit ose zëvendësimin e saj me një masë më të lehtë dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.31, datë 23.6.2008 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë është dhënë në respektim të ligjit, prandaj duhet të mbetet në fuqi.

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Prokuroria për Krime të Rënda në vitin 2007 ka regjistruar procedimin penal nr.50, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a paragrafi i dytë në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal. Nga hetimet e zhvilluara, ndërmjet të tjerave, ka rezultuar se edhe kërkuari në këtë gjykim, Rexhep Cuku, dyshohet që me veprimet e tij ka kryer veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit në bashkëpunim me persona të tjerë në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 298/3 e 333/a të Kodit Penal.

Mbi bazën e provave të paraqitura dhe shqyrtuara në seancë gjyqësore, Gjykata për Krime të Rënda, me vendimin nr.20, datë 23.1.2008, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” ndaj kërkuarit Rexhep Cuku, pasi ka krijuar bindjen për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit në bashkëpunim me persona të tjerë në formën e grupit të strukturuar kriminal, të parashikuar nga nenet 298/3 e 333/a të Kodit Penal. Kjo gjykatë ka konstatuar ekzistencën e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal sipas nenit 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale, përfshirë ato mbi përshtatshmërinë e llojit e të masës së sigurimit në raport me nevojat e sigurisë, rëndësinë e faktit, rrezikshmërisë së lartë të veprës penale e të personit nën hetim, si dhe të sanksioneve të parashikuara në dispozitën përkatëse materiale penale.

Me vendimin nr.10, datë 23.2.2008 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka vendosur miratimin e vendimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Në datë 2.5.2008, mbrojtësi i shtetasit Rexhep Cuku ka kërkuar revokimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, lirim të menjëhershëm të të mbrojturit prej tij apo zëvendësimin e kësaj mase me një masë më të lehtë të parashikuara prej neneve 234 e 237 të Kodit të Procedurës Penale. Këtë

kërkesë e mbështet në urdhërimet që përmbahen në dispozitën e pikës 6 të nenit 246 të këtij Kodi. Sipas mbrojtjes, organi i prokurorisë nuk ka përmbushur detyrimin e parashikuar nga ligjvënësi për të informuar gjykatën çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit. Këtë rrethanë mbrojtja e pretendon si shkak të ligjshëm për revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit personal për subjektin Rexhep Cuku, vetvetiu dhe në mënyrë të menjëhershme, si përmbushje e kriterëve të parashikuara nga neni 260, pikat 1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj kërkesë Gjykata për Krime të Rënda ka vlerësuar se organi i prokurorisë nuk e ka informuar me shkrim gjykatën mbi gjendjen e procedimit, në afatin ligjor dymujor, sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale. Në interpretim të kësaj dispozite, në seancë gjyqësore, gjykata ka urdhëruar organin e prokurorisë që të paraqesë informacion me shkrim për gjendjen e procedimit në ngarkim të kërkuesit së bashku me aktet përkatëse nga fashikulli i dosjes hetimore. Duke zbatuar urdhërimin e gjykatës, prokurori ka paraqitur në seancë informacionin përkatës, me shkrim, si dhe kopje të akteve procedurale që lidhen me procedimin në ngarkim të shtetasit Rexhep Cuku.

Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata për Krime të Rënda me vendimin nr.94, datë 20.5.2008 ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Kjo gjykatë arsyeton se mospërmbushja nga prokuroria e detyrimit ligjor të parashikuar në pikën 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale për dërgimin në gjykatë të informacionit periodik dymujor mbi gjendjen e procedimit në ngarkim të kërkuesit, nuk passjell automatikisht revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit. Ligji procedural penal, në veçanti neni 260 i këtij Kodi, kërkon që njëkohësisht të vërtetohet se me kalimin e periudhës dymujore nuk ekzistojnë apo kanë ndryshuar rrethanat e pranuar më parë lidhur me nevojat e sigurimit për zbatimin e masës së arrestit në burg, ose këto nevoja sigurimi apo masa e sigurimit personal të mos i përgjigjet më rëndësisë së faktit a masës së dënimit për të pandehurin. Në gjykim nga provat e administruara nuk vërtetohet ndryshimi i rrethanave në lidhje me kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave ishte caktuar masa e sigurimit personal arrest në burg.

E investuar mbi ankimin e kërkuesit Rexhep Cuku, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.31, datë 23.6.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Duke çmuar të mbështetur në ligj arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda shton se bazuar në informacionin dhe aktet e paraqitura në atë gjykim nga prokuroria, provohet se gjatë hetimit janë kryer disa veprime hetimore të nevojshme për çështjen dhe janë duke u kryer disa të tjera, ndërkohë që kërkuesi nuk parashtroi ndonjë provë që të vërtetojë se nuk ekzistojnë apo janë zbutur nevojat e sigurimit. Po kështu, gjykata e apelit arsyeton se nuk qëndron pretendimi për zbatimin e pikave 1 e 2 të nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale, si rrjedhojë e mosrespektimit të pikës 6 të nenit 246 të tij, sepse këto dy dispozita përfaqësojnë në vetvete institute të ndryshme të së drejtës procedurale penale. Neni 246 zbatohet kryesisht nga gjykata, pa kërkesë të palëve, ndërsa neni 260 kërkohet prej palëve, gjë që bën të pavend vendosjen e tyre së bashku në një bazë ligjore për kërkesën.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs kërkuesi Rexhep Cuku me anë të mbrojtësit të tij, duke i parashtruar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të njëjtat pretendime si në gjykimin e shkallës së parë e në apel në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit procedural penal nga gjykatat.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 29.9.2008, duke çmuar rëndësinë dhe mungesën e praktikës gjyqësore të njësuar në zbatimin e dispozitës së pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur që çështja të kalojë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duke parashtruar për shqyrtim sa vijon:

“1. Mungesa e paraqitjes së informacionit nga ana e prokurorisë, në afatin e përcaktuar nga neni 246/6 i KPP-së, për zbatimin e masës së sigurimit të arrestit, të caktuar me një vendim gjyqësor, a legjitimon paraqitjen e kërkesës për revokimin e masës së sigurimit me arrest nga ana e subjektit ndaj të cilit është vendosur kjo masë?

2. Në të njëjtat kushte (mungon informacioni i organit të prokurorisë), në rast se mungon një kërkesë e tillë nga ana e subjektit ndaj të cilit është vendosur masa, a duhet që gjykata kryesisht të kërkojë informimin e saj nga ana e prokurorisë?

3. Në rast se vetë gjykata legjitimohet të kërkojë këtë informacion nga ana e organit të prokurorisë, shqyrtimi i këtij informacioni, që shoqërohet me aktet e parashikuara nga neni 246/6 i KPP-së, a do të kryhet në rrugë administrative apo në seance gjyqësore?

4. Në kushtet kur gjykata merr në shqyrtim zbatimin e vendimit të arrestit sipas dispozitës së nenit 246/6 të KPP, në interpretim të shprehjes “mund të revokojë ose të zëvendësojë masën e sigurimit” do të kuptohet analizimi i rasteve të parashikuara nga neni 260 i KPP-së?”

Pasi shqyrtuan çështjen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i gjejnë të pambështetura në ligj pretendimet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi Rexhep Cuku për revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit dhe vlerësojnë të drejtë e të bazuar në ligj vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Ushtrimi i së drejtës për të kërkuar revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit sipas pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe mënyra e procedura e ndjekur për shqyrtimin, gjykimin dhe dhënien e vendimit për zgjidhjen e çështjes, në tërësi, janë zhvilluar duke respektuar parimet e procedimit penal dhe dispozitat procedurale penale. Por, ndonëse nuk cenojnë drejtësinë e vendimit të dhënë përse i përket zgjidhjes në themel të çështjes, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, sikurse në kërkimet e qëndrimet e palëve, ashtu edhe në arsyetimet e gjykatave ka edhe interpretime të gabuara të ligjit. Prandaj, duke i analizuar këto kërkime e qëndrime në funksion të zgjidhjes së çështjes, Kolegjet e Bashkuara do të shprehen edhe për interpretimin e unifikuar mbi qëllimin dhe mënyrën e zbatimit të drejtë të dispozitës së pikës 6 të nenit 246 të këtij Kodi.

Në kërkesën për revokimin ose zëvendësimin e masës së arrestit drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë, por edhe në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit dhe në rekurs, krahas pretendimit se nuk është marrë në pyetje dhe as janë kryer veprime të tjera hetimore lidhur me të, kërkuesi Rexhep Cuku parashtron edhe se organi i prokurorisë, në kundërshtim me dispozitën e pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka përmbushur detyrimin për të informuar Gjykatën çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit. Këtë rrethanë mbrojtja e pretendon si shkak të ligjshëm për revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit personal për subjektin Rexhep Cuku, vetvetiu dhe në mënyrë të menjëhershme, si përmbushje e kriterëve të parashikuara nga neni 260, pikat 1 e 2 të këtij Kodi. Ky qëndrim i prokurorisë, sipas kërkuesit, njëkohësisht përbën cenim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara në Kushtetutë dhe në Konventen Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe të atyre që parashikohen në nenin 248 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në të gjitha shkallët e gjykimit, edhe përpara Kolegjeve të Bashkuara, përfaqësuesi i organit të prokurorisë ka pranuar se në rastin konkret janë lejuar mangësi në përmbushjen e detyrimit që i ngarkon organit të prokurorisë dispozita e pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, sipas prokurorit, kjo mangësi nuk mund të interpretohet si shkak për revokimin vetvetiu të masës së sigurimit personal të arrestit në burg të caktuar nga gjykata ndaj të pandehurit Rexhep Cuku, për të cilin, edhe pas caktimit të kësaj masë, kanë vijuar hetimet duke u realizuar veprime të tjera hetimore për kryerje të veprës penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit në formën e grupit të strukturuar me persona të tjerë, të parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal.

Ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, kanë arsyetuar se tejkalimi i afatit dymujor për informimin mbi gjendjen e procedimit sipas pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale nuk passjell automatikisht revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit, sepse, njëkohësisht, duhet të vërtetohen edhe rrethanat e parashikuara nga pikat 1 e 2 të nenit 260 të këtij Kodi.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se duhet të mbahet parasysh që kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin dhe përgjithësisht kontrollin gjyqësor mbi masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë posaçërisht dhe drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, konkretisht me lirinë e personit. Prandaj, për arritjen e përfundimeve të nevojshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes, përfshirë edhe ato me natyrë unifikuese, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të domosdoshme edhe analizën dhe interpretimin e dispozitave përkatëse të Kushtetutës, Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e atyre të Kodit të Procedurës Penale, duke u fokusuar edhe në jurisprudencën shumë të pasur për këtë fushë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kushtetuta, në parimet e përgjithshme të saj, parashikon se “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik” (neni 15). Këto të drejta mund të kufizohen, në përpjestim me gjendjen që ka diktuar kufizimin, vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Nga ana tjetër,” këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (neni 17).

Lidhur me garantimin e lirisë së personit, në nenin 27 të Kushtetutës parashikohet se “askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj”. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e treguara në këtë dispozitë. Ndërmjet rasteve të tjera është ai i parashikuar në shkronjën “c”: “kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”.

Në dispozitat vijuese të Kushtetutës, parashikohen garancitë për personin që i nënshtrohet kufizimit të lirisë dhe ndjekjes penale në tërësi. Ndërmjet të tjerave, në nenin 28 parashikohet se: “Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet....për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij” (pika 1). Po kështu “i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit”(pika 3).

Në kontekstin e kufizimit të lirisë së personit vlen të evidentohet rëndësia e garancisë kushtetuese se “Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë” (neni 30).

Ndërsa në nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore sanksionohen parime të përgjithshme për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garancitë për personin që kufizohet në të drejtën e lirisë personale parashikohen më hollësisht në nenin 5 të saj.

Sipas kësaj dispozite, kufizimi i lirisë legjitimohet vetëm në rrugë përjashtimore dhe “... në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj...”. Një nga rastet është ai i parashikuar në pikën 1 shkronja “c”: “...kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një veprë penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një veprë penale ose të largohet pas kryerjes së saj”. Konventa, në pikat 3 dhe 4 ofron disa garanci të tjera thelbësore lidhur me kufizimin e lirisë, pikërisht ato të kontrollit efektiv gjyqësor, të ushtruar nga gjykata të pavarura brenda afateve të shkurtra dhe të arsyeshme:

“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1/c të këtij neni, duhet të çohet menjëherë përpara një gjykatesi dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër....”

“4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim..... ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.”

Në zbatim të këtyre parimeve dhe dispozitave të Kushtetutës e Konventës, Kodi i Procedurës Penale, veçanërisht në titullin VI “Masat e sigurimit”, parashikon rregulla të hollësishtme edhe për masat e sigurimit personal. Nenet 228 e 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit. Ndërsa neni 230 parashikon disa kriteret të veçanta lidhur me caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”. Këtu vlen të theksohet natyra përjashtimore e masës arrest në burg, e cila “...mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme...”. Në nenet 244 deri 249 parashikohen caktimi dhe zbatimi i masave të sigurimit, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të procedimit penal, përfshirë ankimin kundër vendosjes e zbatimit të tyre. Përveç të tjerave, në këto dispozita sanksionohet kontrolli rigoroz gjyqësor në caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, përfshirë detyrimin thelbësor të gjykatave për t'i shqyrtuar dhe vendosur mbi kërkesat e ankimit me shpejtësi (në një kohë të shkurtër) dhe brenda një afati të arsyeshëm.

Në nenin 260 parashikohet revokimi dhe zëvendësimi i masave të sigurimit, përkatësisht nëse mungojnë apo janë zbutur kushtet dhe kriteret e lartpërmendura të zbatimit të tyre. Ankimi e kërkesat përkatëse të prokurorit dhe të pandehurit mund të paraqiten në çdo kohë dhe duhet të shqyrtohen brenda afateve të shkurtra nga ana e gjykatës.

Vlerësuar në këtë kontekst, vjen përfundimi se Kodi i Procedurës Penale parashikon të drejtën e palëve për të kërkuar në çdo kohë revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit. Por, në respektim të garancisë së lirisë së personit dhe të parimit mbi prezumimin e pafajësisë, duke u nisur nga natyra përjashtimore dhe e përkohshme e caktimit dhe zbatimit të masës së arrestit në burg, nga natyra jo ndëshkimore e domosdoshmëria për justifikimin kohë pas kohe e në vijimësi të përshtatshmërisë (proporcionalitetit) së caktimit të kësaj mase në raport me veprën e pandehur, ligjvënësi ka nxjerrë gjithashtu, edhe një dispozitë me natyrë të veçantë. Me anë të kësaj dispozite ligjvënësi synon që ekzistencën e ligjshmërisë së vijimit të zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg” t'ia nënshtrojë verifikimit të detyrueshëm, periodik, në rrugë gjyqësore. Prandaj, në pikën 6 të nenit 246 të Kodit të

Procedurës Penale parashikohet se: “Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet nga prokurori për të arrestuarin. Informacioni jepet me shkrim dhe përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, për pyetjen e të pandehurit dhe të personave të tjerë, për përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur është rasti, gjykata mund të revokojë ose të zëvendësojë masën e sigurimit.”

Në çështjen objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në interpretim të drejte të ligjit, gjykatat kanë marrë në shqyrtim dhe gjykuar kërkesën për revokim ose zëvendësim të masës së sigurimit të paraqitur sipas pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, duke zbatuar të njëjtat procedura e garanci, sikurse edhe në rastet e tjera të ankimimit kundër masave të sigurimit (neni 249), përfshirë këtu garancinë e lidhur me të drejtat e liritë themelore të njeriut për zhvillimin e një gjykimi të kujdesshëm (diligjent) dhe me shpejtësi të çështjeve të kësaj natyre. Po kështu, shqyrtimi i kërkesës dhe pretendimeve janë bërë në seancë gjyqësore.

Me të drejtë gjykatat kanë pranuar pretendimin e kërkuarit dhe vlerësuar si shkelje të ligjit procedural nga ana e prokurorisë, mosrespektimin e afatit dhe mosdërgimin e informacionit të prokurorit mbi gjendjen e procedimit në lidhje me kërkuarin. Më tej, me të drejtë gjykatat kanë çmuar riparimin e menjëhershëm të kësaj shkeljeje, duke urdhëruar prokurorin të paraqesë në seancë informacionin me shkrim dhe kopjet e akteve përkatëse, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuarit për t'i krijuar mundësinë të parashtrorë qëndimin e kërkesat. Më të drejtë gjykatat kanë krijuar në këtë mënyrë kushtet për lejimin e zhvillimit dhe debatit mes palëve mbi materialin e paraqitur. Pasi kanë çmuar dhe analizuar në vendimin e tyre nëse mbi bazën e informacionit ka apo jo vend për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit, me të drejtë gjykatat kanë çmuar se është vendi për rrëzimin e kërkesës, mes të tjerave duke arsyetuar edhe se vetëm mosrespektimi i detyrimit për informim apo dërgimi me vonesë i tij, nuk sjellin vetvetiu revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit.

Por, nga ana tjetër, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se në interpretim të gabuar të ligjit, pa pasur parasysh qëllimin dhe veçantitë e normës së zbatueshme, gjykatat e lidhin pranimin e kërkesës për revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit sipas pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, në çdo rast e vetëm me vërtetimin e mungesës apo zbutjen e rrethanave të pranura më parë prej tyre në caktimin e masës së sigurimit, të parashikuara shprehimisht në pikat 1 e 2 të nenit 260 të këtij Kodi. Po kështu, gjykata e apelit interpreton në mënyrë të gabuar ligjin kur arsyeton se nuk mund të bëhet kërkesë për zbatimin e nenit 260 si rrjedhojë e mosrespektimit të pikës 6 të nenit 246 të tij, meqenëse në rastin e fundit norma zbatohet kryesisht nga gjykata, pa kërkesë të palëve, ndërsa për zbatimin e nenit 260 nismën e kanë palët nëpërmjet paraqitjes së kërkesës përkatëse.

Kolegjet e Bashkuara vërejnë se dispozitat e neneve 27, 28 dhe 30 të Kushtetutës sonë përkojnë me qëllimin dhe interpretimin e nenit 5 të Konventës, e cila, së bashku me nenet 2, 3 e 4 të saj janë themeli i të drejtave themelore të njeriut, përse i përket mbrojtjes së sigurisë fizike të individit, posaçërisht edhe të lirisë së personit. Duke interpretuar këto dispozita, Gjykata Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se: “Qëllimi kryesor i tyre është të parandalojnë deprivimin arbitrar ose të pajustificuar të lirisë.” (Castravet kundër Moldavisë, 2007).

Pikat 1 dhe 2 të nenit 28 të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 5 të Konventës sanksionojnë të drejtën e njeriut që, nëse parashtron kërkesa e pretendime të lidhura me heqjen apo ndryshimin e masës së sigurimit personal, veçanërisht asaj të arrestit, “ato duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor nga gjykata”. Kontrolli gjyqësor lidhur me veprimet e organit të akuzës që prekin të drejtën e lirisë personale, përbën një element thelbësor të garancisë së parashikuar në pikën 3 të nenit 5 të Konventës kundrejt mundësisë së ushtrimit arbitrar dhe të pabazuar në ligj të kompetencave nga organi i akuzës (Schiesser kundër Zvicrës, 1979). Prandaj, nisur nga këto përfundime, duke pasur parasysh se veprimi i parimit të kontrollit gjyqësor mbi masën e arrestit mishërohet mes të tjerave edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata kompetente duhet ta shqyrtojë me shpejtësi çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar prokurorin dhe pretendimet përkatëse të individit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit ose mbrojtësin e tij. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbështetur në parimet e normat kushtetuese dhe ndërkombëtare të detyrueshme si më sipër, si dhe kriteret ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, gjykata duhet të vendosë nëse kufizimi i lirisë për të arrestuarin është ose jo e justifikuar ligjërisht.

Mjeti procedural garantues i parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, i cili duhet të respektohet rigorozisht nga palët e tjera në procedimin penal dhe gjykata, gjën zbatim krahas garancisë tjetër kushtetuese e ligjore që i njihet në mënyrë të pavarur vetë të arrestuarit për të kërkuar në

çdo kohë e rrethanë në gjykatë revokimin apo zëvendësimin e masës së sigurimit. Në të dy këto raste, procedura përkatëse e gjykimit duhet të ofrojë garancitë e duhura në kontekstin e një gjykimi që ka për objekt shqyrtimin e një kërkesë që lidhet me caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të një masë që ka të bëjë me kufizimin e lirisë së individit. (Assenov e të tjerë kundër Bullgarisë, 1998).

Përsa i përket natyrës dhe llojit të gjykimit, në interpretim të drejtë të pikës 6 të nenit 246 në harmoni me dispozitat e tjera të Kodi të Procedurës Penale, duhet të mbahet parasysh se synimi i saj nuk është të vendosë një komunikim të qëndrueshëm në linjën gjykatë-prokurori. Qëllimi i ligjvënësit është që prokurori të detyrohet të informojë periodikisht Gjykatën për gjendjen e procedimit, në mënyrë që kjo e fundit të garantojë se ky informacion, kjo gjendje, të bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor. Kështu, në përfundim të gjykimit, mbi kërkesat e pretendimet e palëve apo kryesisht, gjykata duhet të çmojë nëse është vendi për revokim apo zëvendësim të masës së sigurimit “arrest në burg”. Në këtë kuptim, sikurse shprehet GJEDNJ-ja, kjo procedurë duhet të jetë të natyrës kontradiktore për të garantuar edhe “barazinë e armëve” ndërmjet palëve. Në rastin kur një person i nënshtrohet një mase “arresti në burg”, që përfshihet në kuptimin e nenit 5/1 (c), duhet të zhvillohet një seancë gjyqësore (Reinprecht kundër Austrisë, 2005).

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se Kushtetuta dhe ligji i kanë caktuar organit të prokurorisë funksionin e ushtrimit të ndjekjes penale, që përfshin edhe detyrimin për ta ushtruar atë në respektim të të drejtave të njeriut e lirive themelore. Prandaj, është në përgjegjësinë e prokurorit kompetent të ndërmarrë nismën e të përbushë, në afat dhe në përmbajtje, detyrimet përkatëse sipas afateve e procedurave që parashikohen nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që gjykata të rishqyrtojë periodikisht legjitimitetin e zbatimit të masës së sigurimit të arrestit, të cilën ajo gjykatë ia ka caktuar individit pikërisht mbi kërkesën e vetë organit të prokurorisë.

Gjykata nuk vihet në lëvizje kryesisht për të kërkuar nga prokurori kompetent përmbushjen e detyrimit të informimit dymujor sipas dispozitës procedurale të lartpërmendur. Detyrimin për vënien në lëvizje të gjykatës, nëpërmjet paraqitjes së informacionit mbi të arrestuarin dhe gjendjen e procedimit, ligjvënësi ia ngarkon prokurorit. Nëse ky i fundit nuk përmbush detyrimin në afat, i arrestuari legjitimohet të kërkojë rishqyrtimin e masës së sigurimit. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, gjykata urdhëron prokurorin të riparojë shkeljen e ligjit duke depozituar menjëherë informacionin dhe të dhënat mbi gjendjen e procedimit, të cilat i nënshtrohen hetimit gjyqësor dhe debatit mes palëve.

Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin tjetër unifikues se edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, sikurse në rastet e tjera kur paraqitet kërkesë nga vetë i arrestuari, në interpretim të zbatim të drejtë të pikës 2 të nenit 28 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të Konventës, gjykata e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore dhe duhet të vendosë, me shpejtësi, për vijimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit.

Gjithashtu, lidhur me legjitimitetin e masës së sigurimit të caktuar më parë, veçanërisht asaj të arrestit në burg, normat e lartpërmendura sanksionojnë edhe detyrimin që gjykimi të caktohet, zhvillohet e përfundojë në një kohë të shpejtë e të arsyeshme, duke verifikuar nëse kërkuesi (i arrestuari) është duke u mbajtur në gjendje arresti për një kohë të gjatë, jo të arsyeshme, aq më shumë nëse autoritetet nuk veprojnë në lidhje me hetimin me diligjencën e duhur (Assenov dhe të tjerë v. Bullgarisë, 1998).

Në këtë kontekst, nëpërmjet zbatimit të dispozitës së pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, synohet edhe që nga ana e subjekteve të procedimit penal të mbahet parasysh se rrethanat e çështjes penale mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, gjë që bën të domosdoshëm zbatimin e një mekanizmi të rishqyrtimit periodik, të detyrueshëm, të masës së sigurimit nga ana e gjykatës, me qëllim që të çmohet nëse masa e arrestit vijon të jetë e justifikuar ligjërisht dhe nuk cenon të drejtat e njeriut.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se i përket në radhë të parë Gjykatës detyrimi që të sigurojë zbatimin efektiv të garancive kushtetuese të lidhura me respektimin e së drejtës themelore të lirisë së personit, në kuptimin që caktimi e zbatimi i masave të sigurimit, veçanërisht asaj të arrestit, të mos tejkalojnë kohën e arsyeshme. Për këtë qëllim, edhe pas caktimit të masës “arrest në burg”, pavarësisht nga mënyra e vënies së saj në lëvizje, në çdo rast, gjykata duhet të shqyrtojë në seancë gjyqësore të gjitha rrethanat e lidhura me ekzistencën ose jo të interesit publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase. Në këtë gjykim ajo mban parasysh edhe respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe natyrën e masës së arrestit si përjashtim nga rregulli kushtetues i respektimit të lirisë individuale.

Kushtetuta dhe Konventa garantojnë të drejtën e individit për të kërkuar në gjykatë verifikimin e ligjshmërisë së ndalimit dhe të masës së arrestit në burg, pavarësisht nga motivet e vendosjes së saj, si

dhe për të fituar revokimin e zëvendësimit e saj nëse nuk është e ligjshme. Praktika jonë gjyqësore është e pasur në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e kushteve dhe kriterëve të përgjithshme e të veçanta për caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit, si dhe për revokimin a zëvendësimin e tyre, veçanërisht në interpretim të neneve 228, 229, 230 dhe 260 të Kodit të Procedurës Penale.

Megjithatë, në kuadër të respektimit të së drejtës themelore të njeriut për lirinë e personit dhe garancive përkatëse në lidhje me të, të sanksionuara nga Kushtetuta e Konventa, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të nevojshme të evidentojnë domosdoshmërinë e interpretimit të drejtë të dispozitave të lartpërmendura, e veçanërisht asaj të pikës 6 të nenit 246, përse i përket interpretimit kushtetues e ligjor të “gjendjes së procedimit” në ngarkim të një personi ndaj të cilit zbatohen masa sigurimi, sidomos ajo e arrestit në burg.

Pika 3 e nenit 28 të Kushtetutës, ku përfshihet edhe qëllimi i përmbajtjes së pikës 3 të nenit 5 të Konventës, nuk mund të interpretohen si një mjet autorizues për të kufizuar lirinë e personit nëpërmjet arrestit në burg në një mënyrë të pakushtëzuar, pavarësisht se Kodi i Procedurës Penale në nenet 263 e vijues të tij ka përcaktuar afatet maksimale përkatëse të kohëzgjatjes së paraburgimit sipas llojit të veprës penale dhe rrethanave të çështjes. Prandaj, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se për çdo periudhë paraburgimi, pavarësisht sa e shkurtër të jetë caktuar ajo, autoritetet duhet të parashtrojnë përpara Gjykatës motive të besueshme që e justifikojnë atë periudhë (Belchev kundër Bullgarisë, 2004).

Derisa nuk është dhënë vendim i dënimit, edhe i arrestuari prezumohet i pafajshëm. Pika 3 të nenit 28 të Kushtetutës, përkatësisht pika 3 e nenit 5 të Konventës, janë garanci thelbësore për individin e arrestuar, të cilat në thelb synojnë të mundësojnë lirinë e përkohshëm të tij përderisa vijimi i zbatimit të masës së arrestit ka pushuar se qeni e arsyeshme (McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2006)

Pra, jo vetëm në caktimin e masës “arrest në burg”, por edhe në shqyrtimin gjyqësor të kërkesës për revokim ose zëvendësimin e kësaj mase në të ardhmen, gjykata duhet të mbajë parasysh se “prezumimi është në favor të liritë” të të arrestuarit. Neni 5/3 i Konventës nuk i jep autoritetit gjyqësor të drejtën të zgjedhë në mënyrë alternative midis dërgimit të të akuzuarit në gjyq brenda një kohe të arsyeshme ose dhënies atij të lirisë së përkohshme deri në kohën e gjykimit. (Neumeister kundër Austrisë, 1968)

Gjithashtu, gjykata nuk mund të mjaftohet në arsyetimin e saj për caktimin e masës së arrestit në burg apo për zgjatjen e afatit të paraburgimit duke u kufizuar thjesht e vetëm në perifrazime standarde, më tepër referuese mbi dispozita të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë kushtet e kriteret për caktimin e masave të sigurimit, pa arsyetuar në mënyrë ezauruese sesi e përse gjejnë ato zbatim në çështjen konkrete (Sarban kundër Moldavisë, 2005). Pra, në arsyetimin e vendimit të Gjykatës duhet të analizohen në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimi ose jo të kërkesës/ankesës për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit dhe jo të bëhet një përshkrim ritual e formal i shkaqeve e kriterëve të parashikuara nga ligji. (Mansur kundër Turqisë, 1995) (Smirnova kundër Rusisë, 2003).

Nisur nga arsyetimet e mësipërme, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se vijimësia e ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që personi i arrestuar ka kryer një vepër penale mbetet një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimësisë së zbatimit të masës së arrestit. Por, pas kalimit të një kohe të arsyeshme, edhe ky motiv nuk mund të qëndrojë më i vetëm si justifikim për zbatimin e masës së arrestit. Prandaj, në një gjykim me objekt rivlerësimin e kësaj mase, gjykata duhet të çmojë e vendosë edhe në vartësi të vërtetimit ose jo të motiveve të tjera të parashtruara nga organi i akuzës për justifikimin e vazhdimi të kufizimit të lirisë së individit.

Në këtë kontekst, sikurse shprehet GJEDNJ-ja, është thelbësore që të mbahet parasysh se për të çmuar nëse motivet fillestare mbeten apo jo “relevante” dhe “suficiente”, gjykata duhet gjithashtu të verifikojë dhe të sigurohet se organet kompetente për ndjekjen penale kanë shfaqur në kryerjen e veprimeve hetimore në atë procedim penal “diligjencë të posaçme”(Labita kundër Italisë, 2000) (Castravet kundër Moldavisë, 2007).

Edhe në këndvështrimin e ligjshmërisë së caktimit dhe vijimit të zbatimit të masës së sigurimit, posaçërisht asaj të arrestit në burg, diligenca, pra kujdesi dhe përpjekjet e duhura, të posaçme, nga ana e organit të akuzës në ushtrimin e ndjekjes penale në një çështje konkrete, është një element dhe aspekt thelbësor i vlerësimit të ekzistencës ose jo të procesit të rregullt ligjor. Madje, nga ky vlerësim nuk bën përjashtim edhe sjellja e Gjykatës në raport me detyrimet e saj procedurale lidhur me pranimin, caktimin për gjykim, shqyrtimin gjyqësor dhe dhënien e vendimit përkatës mbi kërkesat për caktimin e masave të sigurimit apo revokimin a zëvendësimin e tyre.

Në lidhje më sa më sipër, në çështjen objekt gjykimi, në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit, ashtu edhe në rekurs, nga ana e kërkuesit Cuku është pretenduar se, pas caktimit të masës “arrest në burg”, nga prokuroria nuk janë kryer veprime hetimore me kërkuesin, në mënyrë që të justifikohet kohëzgjatja e zbatimit të kësaj mase në ngarkim të tij. Ndërsa prokurori pretendoi dhe paraqiti të dhëna të procedimit penal, sipas të cilave ekzistojnë një numër i madh veprimesh hetimore të lidhura me fazën e hetimit të kësaj çështjeje penale në ngarkim jo vetëm të kërkuesit, por edhe personave të tjerë, të akuzuar për kryerje të veprës penale në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, në vështrim të vlerësimit të respektimit të detyrimit për përkujdesje dhe përpjekje të duhura (diligence) për hetimin e çështjes nga organi i akuzës, me të drejtë gjykatat e faktit kanë rrëzuar këtë pretendim të kërkuesit Cuku. Ato kanë arsyetuar se mbi bazën e provave të administruara lidhur me këtë çështje penale, nga organi i akuzës janë kryer e vijnë të kryhen një numër i madh veprimesh hetimore që lidhen edhe me akuzën në ngarkim të të arrestuarit Cuku, për veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit në formën e grupit të strukturuar me persona të tjerë, të parashikuar nga nenet 298/3 dhe 333/a të Kodit Penal.

Kolegjet vlerësojnë se, ndonëse e kanë zgjidhur drejt çështjen, gjykatat e faktit arsyetojnë në mënyrë të gabuar kur vetëkufizohen dhe lidhin shqyrtimin e informacionit dhe të kërkesave sipas pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale vetëm me mosvërtetimin e asnjërit prej rasteve të parashikuara në nenin 260 të këtij Kodi. Në fakt, interpretimi i drejtë i pikës 6 të nenit 246 lidhet jo vetëm thjesht me vlerësimin nga gjykata të gjendjes së të arrestuarit, në kuptim të ekzistencës, ndryshimit a shuarjes, me kalimin e kohës, të kushteve e kritereve të parashikuara në nenet 228, 229, 230 e 260 të këtij Kodi.

Gjykata shqyrton dhe vlerëson informacionin për të arrestuarin, të lidhur dhe me gjendjen e procedimit në tërësi, edhe në këndvështrimin e respektimit të procesit të rregullt ligjor përsa i përket ushtrimit ose jo nga ana e prokurorit të ndjekjes penale me përkujdesje dhe përpjekje të duhura, pra si në aspektin e kohëzgjatjes, ashtu edhe të përmbajtjes së veprimeve hetimore të kryera, të cilat e justifikojnë ose jo kohëzgjatjen dhe vazhdimin e zbatimit të masës së arrestit. Në këtë kuadër, gjykata shqyrton dhe vendos mbi informacionin për të arrestuarin në harmoni me përfundimet që nxjerr nga shqyrtimi i gjendjes se procedimit në tërësi, pra jo domosdoshmërisht e vetëm lidhur me veprimin hetimor të pyetjes ose jo të të arrestuarit, por edhe të personave të tjerë, si edhe me veprime të tjera hetimore efektivisht të lidhura me ta dhe hetimin e çështjes penale konkrete.

Caktimi i masës së sigurimit “arrest në burg” kërkon domosdoshmërisht vërtetimin e ekzistencës së kushteve përkatëse, pra të dyshimit të bazuar në prova, rrezikut për marrjen ose vërtetësinë e provës, për largimin e të pandehurit apo kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të pandehur apo të vetë të pandehurit të parashikuara nga neni 228 i Kodit të Procedurës Penale, si edhe të kritereve të neneve 229 e 230 të këtij Kodi.

Por, nga ana tjetër, në pikëpamje të ligjshmërisë së saj, vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, nuk mund të jetë i pakufizuar dhe i pakushtëzuar nga detyrimi për justifikimin e kryerjes së veprimeve hetimore të domosdoshme në pikëpamje të kohëzgjatjes dhe përmbajtjes së tyre. Në interpretim të Kushtetutës dhe Konventës, caktimi dhe vazhdimi i zbatimit të masës së arrestit në burg janë të lidhura me garantimin e interesit publik për ushtrimin e ndjekjes penale, i cili, nga ana e tij, në mënyrë proporcionale, duhet të justifikohet me zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, pra me respektimin e të drejtave të njeriut, ku padyshim bën pjesë e drejta e lirisë së personit, natyra rigorozisht përjashtimore dhe e përkohshme e kufizimit të lirisë së tij, si dhe prezumimi i pafajësisë. Mosveprimi, zvarritjet, mungesa e dilijencës për të kryer në afate të arsyeshme veprimet hetimore të duhura dhe realisht të lidhura me akuzën në ngarkim të të arrestuarit në një çështje konkrete, përbëjnë ushtrim arbitrar të kompetencës nga prokurori me pasojë cenimin e të drejtave themelore të tij dhe shkeljen e procesit të rregullt ligjor.

Në vijim të analizës së mësipërme, mbështetur në të gjitha normat kushtetuese e të Konventës të përmendura në këtë vendim lidhur me garantimin e lirisë personale dhe zbatimin përjashtimisht të kufizimit të saj për një kohë rigorozisht të caktuar, në dispozitat procedurale penale të nxjerra në zbatim të tyre, edhe në kontekstin e zbatimit të drejtë të pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: Organi i prokurorisë ka barrën e provës për të vërtetuar përpara Gjykatës se ende ka bazë të justifikuar për vijimin e zbatimit të masës së arrestit. Objekti i informacionit të detyrueshëm nga prokurori, parashtrimi i kërkesave të palëve për revokim a zëvendësim të masës së arrestit, si dhe objekti i gjykimit mund të shtrihen edhe përtej ekzistencës ose jo të motiveve fillestare që kanë justifikuar caktimin e masës së arrestit në burg, nga ato që parashikohen në

kushtet dhe kriteret e neneve 228, 229, 230 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Në kuptim të pikës 6 të nenit 246 të këtij Kodi, në shqyrtimin gjyqësor dhe dhënien e vendimit për secilën çështje konkrete, gjykata nuk kufizohet vetëm në rrethanat që parashikohen në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 27 të Kushtetutës (shkronja “c” e pikës 1 të nenit 5 të Konventës), kryesisht të materializuara në nenet 228-230, si edhe në dispozitën e nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale. Njëkohësisht, gjykata duhet të mundësojë një gjykim ku të realizohet efektivisht verifikimi ezaurues, jo formal, i “gjendjes së procedimit” në tërësi, pra i të gjitha rrethanave dhe kushteve thelbësore për ligjshmërinë e vazhdimit të zbatimit të masës së arrestit në burg, ku përfshihet edhe vlerësimi mbi diligjencën e posaçme-kujdesin dhe përpjekjet e duhura, të justifikueshme, të organit të prokurorisë për përmbyshjen si në kohë ashtu edhe në substancë të veprimeve hetimore sipas ligjit posaçërisht në raport me rrethanat e procedimit penal objekt i atij gjykimi.

Kur vërtetohet në gjykim, në vartësi të shkallës së mungesës së diligjencës në hetim, qoftë edhe vetëm për këtë shkak, gjykata mund të vendosë revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit. Në dhënien e këtij vendimi, gjykata duhet të mbajë parasysh edhe rrethanat e tjera të çështjes konkrete, të lidhura me kushtet e kriteret e parashikuara në ligj mbi caktimin e masave të sigurimit.

Në zbatim të pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, në gjykim, të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij duhet t’i garantohet mundësia për t’u njohur me informacionin e paraqitur nga prokurori dhe kopjet e akteve të fashikullit që shoqërojnë atë dhe që lidhen me të arrestuarin, si dhe me ato që eventualisht paraqiten nga prokurori në seancë për të justifikuar vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit arrest në burg.

Respektimi i kësaj garancie lidhet me të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garanci që parashikohet shprehimisht nga dispozita e pikës 3 të nenit 28 të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 5 e nenit 6 të Konventës. Njëkohësisht në interpretim të dispozitës së nenit 279 të këtij Kodi, prokurori ka të drejtën që të dhëna të caktuara t’i parashtrijë në informacione të gjykim në mënyrë të përshtatshme që nuk dëmton hetimin, duke i njoftuar Gjykatës nevojën e ruajtjes së sekretit për këto veprime hetimore të caktuara. Sikurse shprehet GJEDNJ-ja, i arrestuari duhet të njihet me qëndrimet e prokurorisë dhe të ketë mundësi reale për t’u shprehur mbi to..... të dhënat që janë thelbësore për të vlerësuar ligjshmërinë duhet t’i bëhen të njohura në çfarëdo forme të përshtatshme të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij..... Ndërkohë që mund të jetë e nevojshme për të mbajtur sekretin mbi disa të dhëna e prova në fazën e hetimit paraprak për të parandaluar që të dyshuarit të dëmtojnë dhënien e drejtësisë (Garcia Alva kundër Gjermanisë, 2001).

Në këtë gjykim, me anë të kërkesës së paraqitur në gjykatë, kërkuesi Cuku ka pretenduar se masa e arrestit që i ishte caktuar duhet revokohet ose zëvendësohet për shkak të mosrespektimit nga prokurori të detyrimit për informim në gjykata dy muaj pas caktimit të masës së sigurimit. Nisur edhe nga qëndrimet e mbajtura nga gjykatat, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të shprehen lidhur me kuptimin dhe interpretimin e drejtë ligjor të pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale përse i përket qëllimit e nevojës së respektimit të afatit dymujor të informimit, si dhe pasojave përkatëse nëse prokurori sillet në shkelje të këtij detyrimi.

Sikurse është përmendur më sipër, me kalimin e kohës, rrethanat lidhur me kushtet dhe kriteret mbi të cilat ishte mbështetur gjykata në caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” mund të ndryshojnë. Prandaj ligjvënësi ka parashikuar të drejtën e të arrestuarit që t’i drejtohet në çdo kohë Gjykatës për revokimin a zëvendësimin e masës, sikurse edhe detyrimin e prokurorit që, pavarësisht nga ushtrimi i së drejtës për rishqyrtim nga vetë i arrestuari, të informojë brenda çdo periudhe kohore të shkurtër dymujore mbi gjendjen e procedimit përse i përket të arrestuarit. Dispozita e pikës 3 të nenit 28 të Kushtetutës, sikundër edhe ajo e pikës 4 të nenit 5 të Konventës, sanksionojnë të drejtën e njeriut, që i është caktuar një masë siguri, veçanërisht ajo e arrestit, për të pasur mundësinë jo vetëm që të kërkojë e të dëgjohet në seancë gjyqësore nga gjykata në lidhje me ligjshmërinë e masës së sigurimit të caktuar ndaj tij gjatë hetimit paraprak, por kjo e drejtë të realizohet vijimisht në mënyrë periodike e në intervale kohore sa më të shkurtra. (Bezicheri kundër Italisë, 1989) (Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2003).

Në lidhje me domosdoshmërinë e garantimit të mjeteve efektive të rishqyrtimit të masave të sigurimit, duhet të mbahet parasysh që natyra e arrestit kërkon zbatimin e afateve kohore të ndërmjetme të shkurtra. Konventa sanksionon prezumimin se kjo lloj mase duhet të zbatohet për një afat kohor rigorozisht të kufizuar (neni 5 paragrafi 3), sepse ekzistenca e tij në thelb është e lidhur me kërkesat për një hetim i cili duhet të realizohet në një kohë sa më të shpejtë (Bezicheri kundër Italisë, 1989).

Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimet unifikuese se dispozita e pikës 6 të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, nëpërmjet parashikimit të intervalit dymujor ndërmjet dy gjykimeve për rivlerësimin e ligjshmërisë së masës së arrestit, synon që i arrestuari të ketë të garantuar të drejtën për të kërkuar shqyrtimin e vlefshmërisë së ligjshmërisë së masës ndaj tij në intervale kohore të arsyeshme. Mosrespektimi apo vonesa nga prokurori në përmbushjen e detyrimit për informim nuk përbën në vetëvete shkak për të legjitimuar pranimin e kërkesës për revokimin a zëvendësimin e masës së sigurimit. Nga ana tjetër, kjo shkelje e ligjit nga ana e prokurorit legjitimon të drejtën e të arrestuarit për t'i kërkuar Gjykatës përmbushjen menjëherë të detyrimit për informim nga prokurori. Duke qenë pjesë e respektimit të procesit të rregullt ligjor, gjykata e mban parasysh edhe këtë rrethanë, duke e çmuar atë në harmoni me rrethanat e tjera që rezultojnë në gjykim nga informimi për të arrestuarin dhe të dhënat në lidhje me gjendjen procedimit, për të ardhur në përfundimin nëse është vendi për revokim a ndryshim të masës së sigurimit.

Së fundi, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, si Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit, kanë marrë në shqyrtim dhe dhënë vendimet në lidhje me pretendimet e parashtruara nga kërkuesi Cuku në kohë të shpejtë dhe të arsyeshme, duke respektuar parimet dhe afatet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale (nenet 249, 260).

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë që është vendi të theksohet se, sikurse në rastin e procedurave për caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor të kërkesave dhe ankesave të lidhura me pretendime për revokimin ose zëvendësimin e kësaj mase, në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, gjykata duhet të garantojë gjykimin me shpejtësi dhe brenda një afati të arsyeshëm të çështjes.

Pika 3 e nenit 28 të Kushtetutës, sikurse pika 4 e nenit 5 të Konventës, lidhur me shqyrtimin e çështjeve për caktimin ose revokimin a zëvendësimin e masës “arrest në burg” sanksionojnë detyrimin e realizmit të tyre me shpejtësi, brenda një afati të shkurtër. Sikurse shprehet GJEDNJ-ja këto dispozita nuk kanë për qëllim të garantojnë vetëm të drejtën e ankimit, gjithsesi ato garantojnë detyrimin e prokurorit dhe Gjykatës që ankimet të shqyrtohen me shpejtësi (Laidin kundër Francës, 2002).

Nga ana tjetër, në interpretim të drejtë të dispozitave të lartpërmendura, në funksion të respektimit e vlerësimit nëse afati i shqyrtimit është i arsyeshëm, në shpejtësinë e gjykitimit përfshihet së pari afati brenda të cilit të arrestuarit i mundësohet e drejta për të ankimuar ligjshmërinë e zbatimit të masës “arrest në burg”.

Së dyti, afati brenda të cilit kërkesa ose ankimi merret në shqyrtim nga gjykatat, i cili duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundshme. Respektimi i shpejtësisë së gjykitimit çmohet sipas rrethanave të çdo çështjeje konkrete, ku përfshihet natyra dhe kompleksiteti i saj. (Luberti kundër Italisë, 1984) (Letellier kundër Francë, 1991) (G.B. kundër Zvicrës, 2000).

Në çështjen objekt gjykimi, kërkesa për revokim të masës së sigurimit është paraqitur në gjykatë në datën 2.5.2008, shqyrtimi i saj ka filluar menjëherë dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë është dhënë në datën 20.5.2008. Ndërsa në Gjykatën e Apelit vendimi është dhënë në datën 23.6.2008. Prandaj, në rrethanat e çështjes konkrete, duke e shqyrtuar atë brenda një afati të përgjithshëm dymujor, Kolegjet e Bashkuara çmojnë së të dy gjykatat kanë zbatuar drejt ligjin duke gjykuar çështjen në afat të shkurtër dhe të arsyeshëm.

Si përfundim Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit e përfundimet unifikuese të lartpërmendura, duke pasur parasysh përfundimet në lidhje me provat e çmuara nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe të Apelit, pretendimet e parashtruara në rekursin e kërkuesit Rexhep Cuku nuk janë të mbështetura në ligj. Prandaj, vendimi i Gjykatës së apelit duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” dhe të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.31, datë 23.6.2008 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.
2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi, që njëson praktikën gjyqësore.

Anëtarë: Shpresa Beçaj (kryesuese), Gani Dizdari, Perikli Zaharia, Spiro Spiro, Evjeni Sinoimeri, Irma Bala, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Ardian Dvorani, Evelina Qirjako, Arjana Fullani, Ardian Nuni, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj, Aleksandër Muskaj, Andi Çeliku.

KËRKESË

Shtetasi Isa Harizaj, i datëlindjes 7.11.1964, lindur në Fier dhe banues në Orikum, kërkon shpalljen të zhdukur të motrës së tij, Valbona Azem Harizaj, e datëlindjes 23.1.1973.

KËRKUESI
Isa Harizaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 7.8.2009
 Doli nga shtypi më 10.8.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë